

numër 3
dhjetor 2015

toka

IME

REVISTË PËR BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL



ZETOR KRISTAL 160

Tharja e frutave në Janjevë



1500 kilogram
domate nga
një rrënjë



Kultivimi i
gështenjave



Përdorimi
i shtresës
te gjedhët



Revolucion
në bletari





Kultivimi i preshit:
MËNYRA MË E MIRË E
KULTIVIMIT NË RADHITJE

3

Kopshtari:
PRODHIMI I DOMATEVE,
SPECAVE DHE
KASTRAVECËVE
NË TRUAJ TORFË



6



Pemëtari:
PËRGATITJA E PEMISHTES
PËR PERIUHDËN E
PREHJES

8

Bujqësi:
NEVOJITET DRITA DHE
TOKA PJELLORE



20



Blegtori:
MAQEDONIA
- E PËRSHTATSHME
PËR DHINË SAANE

32



FEDERATA E FERMERËVE NË
REPUBLIKËN E MAQEDONISË

FEDERATA E FERMERËVE NË R.M.

Adresa: rr. Hristo Smirnenski nr.15 1000 Shkup
Tel:389 02 3099 044, Faks:389 02 3099 044
e-mail: ffrm@ffrm.org.mk
uebfaqe:www.ffrm.org.mk



AGROPUKA

Adresa: Lagjja e Re, Pukë
Tel.+355 212 2 2412. Mob.:+355 68 23 88 169/
+35569 57 42 060/ +35567 20 70 490
e-mail: agropuka@gmail.com
uebfaqe: www.agro-puka.org



AGRINET ALBANIA

Adresa: Lagja 7 rr. "Ligor Rembeci"
Nr. 8, Korçë Albania
Tel: +355 82254655, Mob.: +355 684060530
Email: info@agrinet.al tpikuli@agrinet.al
uebfaqe: www.agrinet.al



INITIATIVE FOR KOSOVA COMMUNITY

Adresa: rr. Gjon Serreçi, p.n, Ferizaj, Kosovë
Tel: 038742190, Mob:+377 (0)44 368 356
Faks: 038742190
e-mail:main@ngoikc.org
uebfaqe:www.ngoikc.org

Revista për bujqësi dhe zhvillim rural "Toka ime" është revista e parë rajonale onlajn në gjuhën shqipe, që u dedikohet të gjitha palëve të interesuara në sektorin bujqësor dhe është e lirë dhe pa pagesë për të gjithë lexuesit. Çdo person fizik dhe juridik nuk ka të drejtë ta printojë dhe shesë revistën "Toka ime" për të realizuar fitim. Pronarë të kësaj reviste janë FFRM, AGRINET, AGROPUKA, IKC për Shqipëri-në, Maqedoninë dhe Kosovën. Ne jemi të hapur për bashkëpunime të reja dhe pronarë të rinj nga shtete të tjera me qëllim të vetëm zhvillim dhe bashkim të rajonit të suazat e sektorit bujqësor.



Toka ime, dhjetor 2015

Botues: FFRM Media

Adresa e selisë dhe redaksisë:
rr. Hristo Smirnenski, nr. 15,
1000 Shkup

Udhëheqës: Bllagojçe Najdovski

Tel/faks: 02 3099042
e-mail: mojazemja@gmail.com

Redaktori kryesor
dhe përgjegjës:
Biljana
Petrovska-Mitrevska

Botuar më:
dhjetor 2015

Fotolajm kopertina
Bllagojçe Najdovski

Përktheu: Jordana Shemko-Georgievska

Gazetar: Monika Risteska

Bashkëpunëtorë profesionale

Dr. Vitor Malutaj, Ing. Arben Jakova, inxh. agr. dipl. Jelica Beshliq, inxh. agr. dipl. Stojan Gligorov, inxh. agr. dipl. Llambe Kucinovski, inxh. agr. dipl. Rankica Bozhinovska, Dr. Zoran Dimov, inxh. agr. dipl. Dimitar Arnaudov, Atanas Dimitrov, dipl. agr. inz. Vanço Zahariev, Sashko Stoshij, Sasho Nikollovski, Tomi Pikuli, Nikolin Karapanci, SabahDjaloshi, Doruntina Kurteshi, Ekrem Bajrami

Dizajn: Brigada dizajn [brigada.mk]

Mënyra më e mirë e kultivimit në radhitje

Preshi është më mirë të mbillet në radhë. Plehërohet me sasi të mëdha të plehut të stallës dhe plehut mineral. Prej plehrave minerale përdoren plehurat NPK në raport 1:2:1. Azoti dhe fosfori hidhen gjatë përgatitjes së sipërfaqes. Plehërohet 2-3 herë. Kultivohet me prodhim në fidanishte. Është e nevojshme që shtresa sipërfaqësore e tokës të jetë e punuar mirë.

Shkruan: dipl. agr. Stojan Gligorov

Preshi hyn në grupin e bimëve që përmbajnë shumë materie ushqyese dhe mjekuese të cilat janë me rëndësi të madhe në ushqimin e shëndetshëm të njeriut dhe është bimë dyvjeçare. Në ushqim përdoret kërcelli dhe gjethet gjatë gjithë vitit. Në vitin e parë formon kërcell shumë të fortë të ashtuquajtur të rremë, që formohet nga një numër i madh gjethesh, tek disa lloje me lartësi deri në 80 cm, kurse në vitin e dytë lartësia mund të arrijë deri në 2 metra, në varësi nga lloji dhe nga teknologjia e kultivimit.

Në kërcell në vitin e dytë formohet një top i madh dhe lule me ngjyrë manushaqe të çelur të cilat më shpesh pllenohen nga insektet, kurse mandej formohet farë mjaft e imët.

Ekzistojnë lloje të importuara dhe të vendit të preshit me kërcell të shkurtër dhe të gjatë. Gjatë vegjetimit kërkon klimë mesatare, kurse më mirë rritet kur temperaturat janë më të ulëta, kurse ato janë ditët

në vjeshtë kur temperatura është midis 15 dhe 20°C. Është rezistent ndaj temperaturave të ulëta deri në -20°C. Gjatë vegjetimit kërkon shumë lagështi, madje edhe në vjeshtën e vonshme. Si kulturë kërkon mjaft materie ushqyese dhe prandaj duhet të kultivohet në sipërfaqe pjellore dhe të strukturuar.

Preshi është më mirë të mbillet në radhë. Plehërohet me sasi të mëdha të plehut të stallës dhe plehut mineral. Prej plehrave minerale përdoren plehurat NPK në raport 1:2:1. Azoti dhe fosfori hidhen gjatë përgatitjes së sipërfaqes. Plehërohet 2-3 herë. Kultivohet me prodhim në fidanishte. Është e nevojshme që shtresa sipërfaqësore e tokës të jetë e punuar mirë.

Mbjellja e fidanishtes kryhet nga mesi i marsit dhe nga fillimi i prillit. Në 1 m² mbillet 8-10 gram farë. Fara mbulohet me përzierje të tokës pjellore, një pjesë rërë dhe një pjesë pleh stalle i djegur. Fidanët zihet mirë nëse i shkurtohen një pjesë e rrënjës. Temperatura në atë periudhë duhet të jetë më e ulët, kurse toka më e lagësht.



Mbjellja kryhet nga fundi i qershorit ose fillimi i korrikut. Është e dëshirueshme të mbillet si kulturë e dytë pas: sallatës, spinaqit, bizeles, drithërave. Mbillet në largësi 20 x 20 ose 25 x 15 cm. Pas mbjelljes në një vend të përhershëm duhet të ujitet menjëherë dhe kështu mirëmbahet gjatë gjithë sezonit. Barërat e këqija shkatërrohen me prashitje dhe me përdorim të herbicideve. Plehërimi i parë kryhet menjëherë pasi bimët të zënë, kurse i dyti kryhet pas 15-20 ditësh. Gjatë sezonit mbrohet kryesisht nga sëmundjet ndryshku i gjetheve, botritis, flaka, kundër insekteve, myku i trullit dhe hudhrës.

Mbledhja kryhet në periudhën vjeshtës. Gjethet që janë dëmtuar gjatë mbledhjes hiqen, kurse majat e gjetheve ose të rrënjës priten. Rendi-menti është 30 deri në 50 t/ha. ●





1500 kilogram DOMATE nga një rrënjë

Shkruan: dipl. agr. inz.
Vanço Zahariev

JA DISA PREJ KARAKTERISTIKAVE TË KËSAJ DOMATEJE HIBRIDE:

- F-1 oktapod është domate interminate (me rritje të pakufizuar) me aftësi për degëzim.
- Sipërfaqja e kurorës është 40-50 m². Nuk kryhet filizim, përkatësisht lihen të gjitha degët dhe lulet të bien për tokë.
- Pema e domates kultivohet dhe rritet nga 14 deri 16 muaj, në sera dhe në 7-8 muajt e parë nuk lihet të japë prodhim, por fokusi është të formimi i degëzimit të saj. Pastaj vijon procesi i formimit të kokrrave.
- Ky hibrid formon lule në për çdo tri gjethe me nga 5-6 kokrra me masë prej 100-110. Për një vit nga një rrënjë mund të mbledhen deri në 14.000 kokrra me masë të përgjithshme prej 1500 kg.

"PEMË DOMATE F-1" ËSHTË HIBRID INDETERMINANT I BIMËS SË DOMATES QË JEP 14.000 KOKRRA IDENTIKE ME PESHË MBI 1,5 TON.

Në natyrë ka shumë bimë të cilat të habisin, por hibridi i domates që mban emrin jo të zakonshëm "Pemë domate F-1" mund të thuhet se është i veçantë. Domethënë këto domate janë një bimë mrekulli e cila rritet në lartësi deri prej 4 metrash dhe kurora e saj ndërthuret nëpër konstruksion mbajtës të të gjithë serës duke zënë një sipërfaqe prej 50 m². Kjo pemë domateje si oktapod jep rreth 14 mijë kokrra pesha e përgjithshme e të cilave është mbi 1,5 ton (1500 kg). Pesha mesatare e një kokrrë është 100-110 gr gjatë së cilës kokrrat e luleve të sipërme nuk janë më të vogla se kokrrat e poshtme. Sistemi i rrënjëve të domateve oktapod është i zhvilluar mirë, kurse aparati i gjetheve është shumë i fuqishëm, domethënë posedon gjithçka për një prodhim stabil. Domatet piqen nga korriku deri në shtator.

Ky hibrid është indeterminant d.m.th. me rritje të fuqishme. Mund të jetojë disa vjet, është rezistent ndaj shumicës së sëmundjeve dhe temperaturave të ulëta, por i ndjeshëm ndaj dëmtuesve. Ka nevojë të ushqehet vazhdimisht me plehra organike dhe minerale sepse jep prodhim të madh, kurse sipërfaqja ku është vendosur rrënja është e kufizuar. Gjatë kultivimit amator të këtij hibridi në serë të zakonshme për një sezon vegjetimi merret një bimë e lartë me rendiment mesatar prej 10 kg. Që të fitohet rendimenti i lartë i preferuar duhet të dihet se ky hibrid duhet të kultivohet në hidroponik sipas instruksioneve të përpunuara me kujdes. ●





Prodhimi biologjik i domateve në serra

Në bujqësinë moderne, kohëve të fundit, prodhimtaria biologjike është në rritje e sipër si rezultat i rritjes së kërkesave të konsumatorëve për një prodhim të shëndetshëm. Sipas Organizatës për Bujqësi dhe Ushqim FAO, shtimi i prodhimit biologjik ka pasur rritje rreth 10%. Kjo do të thotë se trendi i prodhimit biologjik është gjithnjë në rritje.

Shkruan:
Doruntina Kurteshi



ÇFARË ËSHTË PRODHIMTARIA BIOLOGJIKE?

Prodhimtaria biologjike është ndër sistemet me një shkallë më të lartë të integritetit të prodhimit me cilësi të lartë duke u bazuar në praktikën më të mira mjedisore. Në prodhimtarinë biologjike, përdorimi i insekticideve, fungicideve, herbicide, hormoneve sintetike, plehrave kimike nuk kanë vend. Këto mjete ndikojnë drejtpërdrejt negativisht në shëndetin e konsumatorëve dhe në ndotjen e ambientit. Në fshatin Godanc të komunës së Shtimës, shtrihet kompleksi i serrave, pronë e Ndërmarrjes Prodhuese "Fidanishtja e Godancit", me pronar Skënder Ramada-

ni. Në këtë kompleks janë të mbjella domatet dhe aplikohet prodhimtaria biologjike. Përdorimi i plehut organik të dekompozuar në këto serra është i pashmangshëm. Në hapësirën për ajrosje të serrave janë vendosura rrjetat që shërbejnë për pengimin e futjes së dëmtuesve dhe njëkohësisht pengojnë daljen e armiqve natyrorë nga serra (PREDATOREVE).

Dihet se një prej dëmtuesve të domateve është edhe KRAHËBARDHA. Në këtë ndërmarrje për luftimin e saj janë përdorur Encarsia Formosa. Dy-tri vitet e fundit në Kosovë është paraqitur edhe TUTA ABSOLUTA e cila është luftuar me përdorimin e FEROMONEVE.

Një vend të rëndësishëm për luftimin e APHIDEVE në këto serra zënë edhe përdorimi i larvave të MOLLEKUQEVE, ndërsa për luftimin e sëmundjeve kërpudhore të tokës është përdorë BIOFUNGICIDI TRIANUM (Trichoderma harzianum T-22 nëpërmjet sistemit të ujitjes).

Dihet se në serra gjatë kultivimit të domateve, paraqiten probleme në procesin e pllenimit. Në këtë serra janë vendosur BLETËT POLENIZU-ESE (Brumbujt). Sipas disa hulumtimeve brumbujt ndikojnë pozitivisht edhe në kualitetin e frutave, por edhe në rritje të rendimentit deri në 25%.

Me përdorimin e këtyre masave në prodhimtarinë biologjike të domateve, sukcesi është i garantuar, prandaj shtrohet pyetja Pse nuk prodhojmë prodhime biologjike?

Me këtë formë e ruajmë shëndetin e konsumatorëve, e ruajmë ndotjen e ambientit (ujit, tokës, ajrit), sidomos në këtë kohë kur bota po ballafaqohet me ndryshimet klimatike.●





PRODHI MI i domateve, specave dhe kastravecëve në truaj torfë

Shkruan: Dimitar Arnaudov

Prodhimi i perimeve në toka artificiale është gjithnjë dhe më i famshëm në botë.

Për këtë trend ekzistojnë dy shkaqe:

★ Problemi me truallin ku për arsye të ndryshme siç janë ndotja e tokës me sëmundje fitopatogene, mbjellje shumëvjeçare monokulturë apo intensive, trualli i keq (pH, struktura, ujërat nëntokësore);

★ Kjo mënyrë e prodhimit është më pak e rrezikshme konvencionale.

Interesi financiar mund të gjenet në dy aspekte në këtë prodhimtari:

★ Siguri dhe stabilitet i të ardhurave – prodhuesit mund të jenë pothuajse të sigurt se do të kenë të ardhura të ngjashme për njësi të sipërfaqes;

★ Kursim i energjisë gjatë prodhimtarisë.





Përparësitë e prodhimit të perimeve në truaj torfë:

- ★ Bima nuk ka kontakt me truall i cili mund të jetë i infektuar me nematode, verticilium, fuzarium dhe shkaktues të tjerë të sëmundjeve si edhe insektet dëmtuese.
- ★ Nuk ka shfaqje të dukurisë "lodhje" e tokës.
- ★ Mundësi për kontrollim të tërësisshëm të rritjes dhe zhvillimit të bimës.
- ★ Kontroll i saktë dhe preciz i ujitjes dhe plehërimit.
- ★ Mundësi për kultivim të më tepër bimëve në një metër katror, në fazat e fillimit të zhvillimit dhe rritjes. Në këtë mënyrë kursehet energji (ngrohje).

Mangësitë e kësaj mënyre për prodhim janë:

- ★ Investime të mëdha në fillim (substrat, saksi ose qese, sistem pikë për pikë, pajisje për të kontrolluar ujitjen dhe plehërimin).



- ★ Shpenzim më i madh i plehrave minerale;
- ★ Nevojiten njohuri të madha dhe profesionalizëm.

➤ Para se të fillojë me zbatimin e kësaj teknologjie të prodhimit, fermeri duhet së pari të bëjë disa përgatitje themelore. Para së gjithash bëhet analizë kimike e ujit për ujitje për këta parametra. pH, EC, Ca, Mg, HCO₃, NA, Cl, NO₃, kurse nëse ka mundësi, duhet të kryejë edhe analizë kimike për prezencën e mikroelementeve në ujin për ujitje. Gjithashtu, edukimi shtesë dhe trajnimi janë me rëndësi të veçantë për çdo fermer i cili do të punonte me këtë teknologji për prodhim.

➤ Veçimi i shtresës torfë (qeset torfë të cilat shërbejnë si medium për zhvillim të sistemit të rrënjëve) nga sipërfaqja bëhet me agrotekstil të trashë (90 -110 g/m²) i cili shtrihet mbi të gjithë sipërfaqen. Pajisja për ushqim duhet të përbëhet nga minimum dy rezervuarë të mëdhenj (TANK A dhe TANK B). Fertigacioni varet nga kultura që kultivohet, si dhe nga fenofaza.●



Shkruan:

dipl. inxhi. agr. Llambe Kucinovski

Ditët në nëntor duhet të shfrytëzohen përgatitja e pemishtes për periudhën e prehjes me zbatim të masave të ndryshme ndihmuese dhe agroteknike. Me të gjitha këto masa pemishtja përgatitet për vegjetimin që vijon. Qëllimi është që bimët të përgatiten për dimrin në vijim dhe të zvogëlohet potenciali i infeksioneve të formave paradimërore të sëmundjeve dhe dëmtuesve në vegjetimin në vijim.

Dëmtuesit siç janë merimanga (merimanga e kuqe), llojet e ndryshme të morave mburojë dhe morave të tjera të bimëve, ngrënësit e luleve, shkaktuesit e sëmundjeve siç është zgjebja e gjetheve, zgjebja e hirtë, zgjebja e frutës, kalbëzimi, kanceri i rrënjës, djegia bakteriale, dimërojnë në gjethet e rënë, në trung, në plagët dhe hapjet në pemë, nën kore në faza të ndryshme të cilat përputhen me ciklin e tyre të shumimit (spore, vezë, larva etj.). Pemëtari me aktivitetet e veta gjatë vjeshtës duhet ta parandalojë zhvillimin e formave të cilat dimërojnë dhe kështu ta parandalojë shfaqjen e tyre në vegjetimin në vijim, ose ta zvogëlojë intensitetin e tyre.

Para së gjithash, duhet të kryhet mbledhja dhe shkatërrimi i gjetheve, degëve dhe pjesëve të dëmtuara të trungut të cilat mund të jenë shkaktues të sëmundjeve potenciale. Në rastin kur bima nuk i rrëzon gjethet (në gjethë ka më tepër se 65% të masës së gjetheve), që të parandalohen pasojat negative, duhet të kryhet trajnim me 5% solucion ure që ka rol të pesticidit. Me solucionin me ure nxitet pema që të rrëzojë gjethet, sepse e pjek gjethen dhe ajo bie, kurse njëkohësisht ka edhe ndikim negativ mbi format paradimërore të sëmundjeve dhe dëmtuesve (sidomos ndaj zgjebes së hirtë). Efekti më i mirë arrihet kur gjethet kanë ngjyrë

Përgatitja e pemishtes për periudhën e prehjes



Gjatë nëntorit duhet të kryhet mbledhja dhe shkatërrimi i gjetheve, degëve dhe pjesëve të dëmtuara të trungut të cilat mund të jenë shkaktues të sëmundjeve potenciale. Në rastin kur bima nuk i rrëzon gjethet (në gjethë ka më tepër se 65% të masës së gjetheve), që të parandalohen pasojat negative, duhet të kryhet trajnim me 5% solucion ure që ka rol të pesticidit. Me solucionin me ure nxitet pema që të rrëzojë gjethet, sepse e pjek gjethen dhe ajo bie, kurse njëkohësisht ka edhe ndikim negativ mbi format paradimërore të sëmundjeve dhe dëmtuesve (sidomos ndaj zgjebes së hirtë). Efekti më i mirë arrihet kur gjethet kanë ngjyrë të gjelbër të zbehtë ose të verdhë.



të gjelbër të zbehtë ose të verdhë. Bima e merr azotin e uresë e transporton deri në rrënjë, degë, sytha ku akumulohet për çelje dhe zhvillim të sythave të luleve, si edhe për zhvillim të lastarëve të rinj në pranverë.

Kur bimët do t'i kenë rrëzuar gjethet, kryhet krasitja. Hiqen degët e thata, të sëmura të thyera dhe të dëmtuara që të parandalohet dimërimi i sëmundjeve dhe dëmtuesve në to me qëllim që të zvogëlohet infektimi. Sidomos duhet të hiqen ato degë të cilat kanë qenë të infektuara me djegien



bakteriale. Në këtë periudhë kur kryhet krasitja dhe pastrimi i pemishtes, duhet të kryhet mbledhja e frutave të mumifikuara, pastrimi i trungut nga korja e vjetër dhe e dëmtuar, pastrimi i plagëve nga kalbëzimi, rrëshira e të tjera, sepse ato janë vende ku mblidhen patogjenë të ndryshëm. Gjatë kryerjes së këtyre aktiviteteve duhet t'i kushtohet vëmendje e veçantë dezinfektimit të mjeteve të punës. Njëkohësisht të gjitha pjesët e pastruara të trungut duhet të dezinfektohen me 5% solucion gurkali dhe të lyhen me dyllë kalemar me qëllim që të parandalohet zgjerimi i mëtejshëm i dëmtimit dhe sëmundjet e ndryshme.

Lyerja me gëlqere e trungut është një mënyrë tjetër për mbrojtje sidomos për plagët prej rrëshirës apo plagët më të mëdha trungut të frutave me kockë apo te pemët të cilat reagojnë shpejt ndaj ndryshimeve të temperaturës. Kjo kryhet maksimum deti në fund të janarit sepse e parandalon shfaqjen e ngrirjes së trungut të pemëve, kurse njëkohësisht arrihet edhe shkatërimi i patogjenëve. Me uljen shkallë-shkallë të temperaturave bima duhet ta ndalojë zhvillimin e vet vegjetativ, ta

zvogëlojë procesin e fotosintezës, krijimin e materialeve ushqyese dhe të fillojë t'i akumulojë në rrënjë, ta zvogëlojë dhe ta ngadalësojë qarkullimin e lëngjeve bimore dhe t'i rrëzojë gjetet. Kur vjeshta është e ngrohtë dhe me diell, temperaturat janë mbi mesataren shumëvjeçare, bima nuk e dallon se ka filluar periudha e përgatitjes për prehje dimërore dhe në atë rast mund të ndodhë që të fillojë të formojë sytha dhe përsëri të formojë fruta. Por kur të bien menjëherë temperatura dhe të jetë ftohtë ndodh ngrirja e sythave të formuara, korja pëlçet dhe trungu ngrin. Por kur lyhet me gëlqere trungu ngjyra e bardhe e gëlqeres i reflekton rrezet e diellit, vështirësohet ngrohja, kjo e ngadalëson lëvizjen lëngut bimor dhe në këtë mënyrë parandalohet ngrirja. Gëlqerja duhet të jetë sa më e bardhë dhe të qëndrojë sa më gjatë në trung, përkatësisht të jetë shumë ngjitëse. Në përbërje të këtij solucion duhet të ketë 5 kg gëlqere të pashuar, 0,5 kg kripë për gatim dhe ¼ kg sulfur pluhur.

Trajtimi i kaltër i pemëve (larja e pemëve) kryhet kur bima i ka rrëzuar gjetet deri në 70% dhe kjo kryhet

me preparate bakri sipas përqendrimit të dhënë. Për në vreshta duhet të përdoret minimum 600l/ha, kurse për pemishtet 1200-1500 l/ha solucion bakri. Me këtë preparat duhet të mbulohen mirë të gjitha pjesët e bimës që të vijë në dukje efikasiteti i tij. Trajtimi bëhet në kohë stabile, pa erë, kur temperatura e ajrit është mbi 10°C. Ky trajnim është masa parandaluese kundër monolisë së gjetheve, plagëve kancerogjene, zgjebeje së hirit dhe patogjenëve të tjerë. Mund të përdoren vajra minerale kundër morave mburojë, preparate me bazë sulfuri për shkatërrimin e poreve të hirit, zgjebes së hirtë, etj.

Në pemishte në këtë periudhë duhet të kryhet edhe plehërimi me plehra organike dhe minerale nëpërmjet lërimit vjeshtor. Thellësia e lërimit nuk duhet të jetë më e madhe e 20 cm që të mos shkaktojë dëmtim të sistemit rrënjor. Normat e plehërimit varen nga lloji dhe karakteristikat e pemëve, vjetërsia e pemishtes, furnizimi i tokës me materie ushqyese. Më shpesh përdoren plehra minerale me përmbajtje të vogël azoti sepse ai kalon shpejt nëpër tokë. ●



Aroma e keqe i largon lepujt

Për mbrojtjen e pemëve të mollës nga lepujt përdoren mjete me aromë të keqe të cilat i largojnë kafshët e egra. Të tilla janë gjak kafshësh, përzierje të ndryshme me vajra dhe materiale të tjera me aromë të keqe. Këto mjet përdoren në vjeshtë, kurse trajnimi përsëritet gjatë dimrit. Rezultate të mira jep dhe lyerja me gëlqere e trungjeve. Lyerja me gëlqere kryhet në vjeshtën e hershme dhe duhet të përsëritet gjatë dimrit kur temperatura e ajrit është mbi 5°C.

Shkruan:
dipl. inxhi. agr. Llambe Kucinovski



Kafshët e egra dhe sidomos lepur i egër (*Lepus europaeus*) u shkaktojnë shumë dëme fidanëve të rinj të të gjitha frutave dhe sidomos mollës.

Në periudhën e dimrit, kur ka dëborë, sidomos kur krijohet lëvorja e fortë, lepur i arrin me lehtësi degët e ulëta, por edhe ato të larta dhe i dëmton në një masë të konsiderueshme. Nëse dëmtimet janë të lëmuara kjo do të thotë se ato i ka shkaktuar lepur.

Pemishtja duhet të mbrohet nga kafshët e këqija. Një prej mënyrave më të sigurta, që njëkohësisht është edhe më e shtrenjta, është vendosja e gardhit në pemishte me rrjetë teli. Mund të mbrohen edhe fidanët duke i mbështjellë me rrjetë teli, me lenta plastike të perforuara, kashtë, me mbeturinat bimore të misrit, me dega shelgu etj. Por nga ana tjetër, mbështjellja e trungjeve e kashtë dhe mbetje bimësh si misri e të tjera i tërheq minjtë.

Lepujt shkaktojnë dëme nga fundi i dimrit. Degët e hequra nga krasitja duhet të vendosen në vende të përshtatshme dhe që mund të gjenden lehtë që lepujt të ushqehen me to.

Për mbrojtjen e pemëve të mollës nga lepujt përdoren mjete me aromë të keqe të cilat i largojnë kafshët e egra. Të tilla janë gjak kafshësh, përzierje të ndryshme me vajra dhe materiale të tjera me aromë të

keqe. Këto mjet përdoren në vjeshtë, kurse trajnimi përsëritet gjatë dimrit. Rezultate të mira jep dhe lyerja me gëlqere e trungjeve. Lyerja me gëlqere kryhet në vjeshtën e hershme dhe duhet të përsëritet gjatë dimrit kur temperatura e ajrit është mbi 5°C.

Mbrojtja më e sigurt prej lepujve arrihet me mbështjelljen e fidanëve me letër rezistente ndaj ujit ose me materiale të përshtatshme. Lyerja e trungjeve me sallo nuk rekomandohet sepse shkakton tharje të bimës.

Lepujt e dëmtojnë pemën duke e ngrënë lëkurën e trungut dhe të degëve dhe duke dëmtuar kështu edhe sythat e luleve. Sorkadhja ushqehet me pemët njëvjeçare që rriten në verë të cilat mund t'i dëmtojnë deri në bazë. Kështu, duke u kuar me brirët e vet e dëmtojnë lëkurën, kurse shpesh ndodh që t'i thyejnë edhe fidanët.

Dëme më të mëdha lepujt shkaktojnë nëse dimri është me dëborë të madhe dhe kur nuk kanë ku të gjejnë ushqim tjetër. Ripërtëritja e fidanëve të dëmtuar nga kafshët e egra është e vështirë, kurse ndonjëherë edhe pa sukses sepse varet nga shkalla e dëmit dhe vendi ku është dëmtuar trungu. Nëse dëmet janë më të vogla, mjafton që korja të lyhet me dyllë kalemi ose fitobalsam, kështu korja e dëmtuar do të ripërtërihet. Nëse korja është dëmtuar rreth të gjithë trungut në formë unaze, në gjatësi

prej disa centimetrash, korja në këtë rast nuk mund të ripërtërihet dhe pemët e tilla do të thahen dhe duhet të zëvendësohen me pemë të reja.

Në rajonet ku ekziston rreziku nga lepuijt dhe sorkadhet, duhet të mbrohen veçanërisht pemët e reja nëse nuk janë me gardh. Mbrojtja, kryesisht kryhet mekanikisht, kurse në një pjesë të vogël edhe kimikisht. Më mirë do të jetë që kopshti të ketë gardh me tel të thurur dhe nëse në rajon ka shumë sorkadhe duhet të vendoset një radhë tel me gjemba. Shtyllat dhe telat ndërmjet tyre duhet të jenë të vendosura fort, që të pengohet futja e lepuijve. Gjatë dimrit kryhet vazhdimisht kontroll dhe nëse shihen gjurmë të kafshëve të egra, vendi ku futen ato të sigurohet menjëherë. Kjo është mënyra më e shtrenjtë e mbrojtjes. Më i lirë është gardhimi me folie PVC. Edhe këtu duhet t'i kushtohet vëmendje sigurimit të bazës së gardhit dhe kontroll të saj sepse stabiliteti i gardhit të tillë në raport me erërat e forta dhe prurjet e shirave nuk është kaq i mirë si tek gardhi me tel të thurur. Ngjyra e zezë dhe mostejdukshmëria e gardhit nga folia PVC e pengon kontaktin vizual.

Një mënyrë e mirë që të mbrohen pemët nga lepuijt është mbështjellja e trungjeve me rrjetë plastike. Këto rrjeta mund të jenë speciale vetëm për këtë punë. Ato janë elastike dhe mund të mbështillen lehtë rreth



trungut, janë afatgjate dhe mund të përdoren për më tepër vjet. Për këtë qëllim mund të përdoren edhe rrjetat plastike që përdoren në ndërtim. Ato duhet të priten në lenta dhe të përforcohen në tri vende. Njëjtë veprohet edhe me lentat e letrës natron, e cila mbështillet rreth pemës dhe përforcohen që të mos grisen nga erërat. Në pranverë lentat e letrës hiqen kurse ato plastiket mund të qëndrojnë ose përsëri i zbresim pak më poshtë që degët e reja të zhvillohen nga sythat të cilat janë mbuluar me rrjetën. Trungjet e mbështjellë në këtë mënyrë janë njëkohësisht të mbrojtur edhe nga temperaturat e ulëta. Nuk rekomandohet përdorimi i folieve polietilike dhe materialeve të tjera plastike, sepse poshtë tyre ndodh kondensimi i ujit.

Mbrojtja më e sigurt nga lepuijt është kombinimi i masave mekanike dhe kimike. Trungu duhet të mbrohet me rrjetë, kurse degët duhet të lyhen

me preparate kimike si për shembull: solucion prej gjakut të kafshës dhe jashtëqitjes së kafshëve, me gëlqere etj. (degët nuk duhet të lyhen me sallo sepse kështu mbyllen sythat e gjetheve. Mund të përdoret vaj peshku dhe materie të tjera të yndyrshme të cilat merren nga kafshët. Me vaj peshku nuk lyhen trunget dhe degët por përdoren shkopinjtë të lyer të cilët lidhen pas trungut.

Ekzistojnë edhe preparate për spërkatje dhe lyerje të trungut dhe degëve. Një preparat i tillë është KUNILENTI i cili si bazë ka vajin e peshkut. Ky preparat nuk rekomandohet te fidanët dhe pemishtet e reja ku janë përdorur desikatorë (mjete për heqje të parakohshme të gjetheve), sepse gjatë dimrit vështirësohet degëzimi i tyre dhe mund të shkaktojë tharje të kores, madje edhe të të gjithë pemës. Lyerja e trungut dhe degëve duhet të bëhet në kohë të thatë kur temperatura është mbi 10°C. ●



Tharja e frutave në Janjevë

Bujqit e fshatit Janjevë i kanë bashkuar forcat e tyre që të realizojnë të ardhura sa më të mëdha, që të edukohen vazhdimisht dhe të jenë në vijim me risitë në fushën e tyre dhe si dhuratë kanë marrë një makineri për tharjen e frutave me kapacitet prej 200 kg frutash në ditë.

Shkruan:

Bllagojçe Najdovski, Monika Risteska

Ekipi i revistës “Toka ime” e ka vizituar kooperativën Teça në fshatin Janjevë në afërsi të Liplanjit që gjendet rreth 30 kilometra larg Prishtinës, fshati është karakteristik i vendosur në një luginë me lartësi prej 600 metrash mbi nivelin e deti. Nëpër rrugën e ngushtë me kthesa arriten në oborrin e Anton Gashit ku është vendosur makineria për tharjen e frutave.

Ky fshat ka një histori të pasur e cila daton prej shekullit të 14. Fshati ka qenë vend i rëndësishëm për tregti me super fuqinë e atëherëshme evropiane, Republika Ragusa

(Republika e Dubrovnikut) ku edhe sot e kësaj dite në këtë fshat jeton një numër i konsiderueshëm i pakicës kroate, thotë Ekrem Teçoli.

“Fshati Janjevë ka traditë shumëshekullore në kultivimin e hardhive të verës dhe është i njohur për vreshtat e rrushit për verë dhe rakinë e mirë si dhe për pemishtet me fruta. Pikërisht për këtë ne vendosëm ta vazhdojmë traditën dhe jemi bashkuar me qëllim që të zmadhojmë edhe përmirësojmë prodhimtarinë. Koha e re kërkon edhe qasje të re, kurse vetëm të bashkuar mund ta bëjmë këtë” – shton Ekremi. “Këtu bëhet rakia më e mirë dhe rriten frutat më të mira. Janë të njohura kajsitë, mollët, dardhat dhe kumbullat e Janjevës,

prandaj në vitin 2008 u mbledhëm 10 bujq dhe e krijuam kooperativën Teça. Anëtarët e kooperativës posedojnë 6 hektarë tokë, por kjo nuk është e mjaftueshme, kështu në punën tonë kemi mbështetje të madhe nga IKC-ja. Një falënderim të madh për ta sepse na ndihmojnë në çdo aspekt nga edukimi deri te këshillat, kurse më e reja është ajo që na kanë dhuruar një makineri për tharjen e frutave”, – thotë Teçoli.

“Bëhet fjalë për makineri për tharje SVP 200. Ajo është makineri për tharje të frutave ku mund të thahet çdo lloj frutash. Kjo makineri për tharje është prej inoksi dhe në përputhje me standardet më të reja të ushqimit. Ka fuqi të instaluar prej 15 kilovatësh dhe sirtarë me



sipërfaqe prej 12 metrash katrorë ku mund të vendosen rreth 200 kilogram fruta dhe ky është kapaciteti ditor për tharje” – shton Teçoli.

Makineria për tharje të frutave është e pajisur me pajisje elektronike për kontroll të temperaturës ku frutat thahen me ajër të ngrohtë në mënyrë të njëtrajtshme në të gjithë sirtarët, kurse temperatura rregullohet automatikisht me ndryshim të lëvizjes së ajrit, termostati elektronik mundëson rregullim preciz të temperaturës me qëllim që të fitohen produkte të thata me cilësi

të lartë. “Si lëndë djegëse përdorim dru, kurse makineria mund të punojë edhe me qymyr dhe mbeturina druri” – thekson bashkëfolësi.

“Që të fitohet një kilogram kumbulla të thata, është e nevojshme të vendosni 4 deri në 5 kilogram kumbulla, kumbullat e thata i shesim me 3 deri në 3,5 euro për kilogram që është një çmim i përkryer nëse merret parasysh se nuk keni ku t’i plasoni mund t’i thani kumbullat dhe kështu zgjidhet një problem i madh i fermerëve, por edhe plasmani. Këtë vit përveç kumbullave kemi tharë

edhe mollë, kurse në të ardhmen duam të thajmë edhe rrush sepse nga Turqia kemi sjellë fidanë hardhie që janë të llojit të rrushit pa fara” – shpjegon Ekremi.

“Makina tharëse është donacion i IKC-së. Ajo kushton rreth 5.000 euro, kurse në të ardhmen duam t’i zmadhojmë sipërfaqet e frutave, por edhe të thajmë më tepër lloje frutash dhe vetëm të bashkuar mund ta arrijmë këtë qëllim” – përfundon Teçoli. ●



IKC i shqyrtoi potencialet e fshatit Teqe dhe i ndihmoi fermerët lokalë



Fermerët e Teqesë kanë punuar në mënyrë individuale dhe të shpërndarë. Tani ata punojnë së bashku, më të fuqishëm dhe më konkurrentë në treg.

Shkruan: Doruntina Kurteshi

Fermerët e fshatit Teqe, i cili gjendet në komunën e Lipjanit, para bashkëpunimit me IKC-në kanë punuar individualisht dhe të shpërndarë. Fermat e vogla, aftësitë e kufizuara në kultivim, mungesa e mjeteve të duhura të punës, janë disa nga problemet të cilat mbizotëruan te këta fermerë. Që nga themelimi i IKC-së, përveç punës në komunat e tjera, Komuna e Lipjanit dhe fshatrat e saj janë përfshirë në të gjitha aktivitetet e projektit. Fillimisht, pasi programi i IKC-së është prezantuar para fermerëve të Teqes, ajo ka tërhequr interesimin e fermerëve me qëllim të fuqizimit dhe arritjen e objektivave të tyre. Nga ky interes i fermerëve, IKC-ja organizoi 11 fermerë në një grup joformal të cilët në mënyrë aktive ndoqën një pako të trajnimeve ekonomike në menaxhim organizativ, shkruarjen e planit të biznesit, shitje dhe marketing dhe të drejtat e grave, me qëllim të zhvillimit të aftësive organizative dhe funksionimit sa më të mirë të grupit. Në vitin 2007 fermerët e Teqes u regjistruan si kooperativë duke marrë parasysh të gjitha mundësitë për përfitime në të ardhmen.

Zona e përshtatshme gjeografike si dhe klima e Teqes lejon ekspozim të mjaftueshëm të diellit dhe reshje të mjaftueshme të shiut. Analiza të tregut janë bërë para fillimit të ndonjë aktiviteti

me IKC-në me qëllim të identifikimit të nevojave të tregut dhe vlerësimi se cilat nga kulturat bujqësore kanë potencial zhvillimi. Duke kombinuar gatishmërinë e fermerëve dhe nevojat e tregut për fruta të freskëta, të gjitha burimet janë orientuar në kultivimin e:

- kumbullave,
- mollëve,
- kajsive dhe
- pjeshkave.

IKC-ja, në kuadër të zbatimit të projekteve të saj, ka kontribuar në kooperativën "Teqe" me 5,000 fidane të këtyre frutave. Trajnime të dizajnuara ekskluzivisht për nevojat e kooperativës për kultivimin e drejtë, mbrojtjen nga sëmundjet, përdorimi i duhur i plehrave si dhe monitorim i vazhdueshëm i IKC-së kanë dhënë rezultate mjaft pozitive si në kultivimin e drejtë të pemëve ashtu edhe në cilësi dhe sasi. Në sezonën kur kooperativa filloi me vjeljen, IKC-ja ka organizuar panaiere bujqësore duke synuar promovimin e produkteve, shitjen, rritjen e kërkesës dhe krijimin lidhjeve midis kooperativës dhe tregut të gjerë. Në fazat e para të operimit të kooperativës nevoja për përkrahje dhe asistencë ishte më e lartë. Kooperativa kishte mungesë të mjeteve të punës për të menaxhuar tanimë sasinë e rritur të

prodhimit. IKC-ja e cila ishte në vazhdimësi partnere e kooperativës, vazhdoi kontributin me atomizer për spërkatje dhe gërrshërë për krasitje. Ky kontribut i rëndësishëm lehtësoi punën e tyre si në spërkatje më efikase dhe krasitje të duhur. Pas një bashkëpunimi të vazhdueshëm, kooperativa "Teqe" ka arritur një stabilitet në prodhim dhe cilësi të frutave. Mirëpo, përgjatë këtyre viteve nevojat e tregut kanë ndryshuar dhe si mundësi është krijuar edhe shitja e frutave të thatë. Një tharëse sa moderne aq ekonomike dhe ekologjike të frutave i është dhënë kooperativës nga ana e IKC-s, kështu që një pjesë e prodhimit dedikohet për treg të freskët ndërsa një pjesë tjetër është tharë. Përveç lëshimit të produkteve në tregun lokal nëpërmjet asistencës së IKC-s, kooperativa ka marrë pjesë në panairin e produkteve bujqësore në Pukë, Shqipëri, me ç'rast u promovua dhe u shitën frutat e thatë si ajo e kumbullës. Në ditën e vijim IKC-ja do të punojë me kooperativën Teqe edhe në diversifikimin e prodhimeve finale të tyre.

Si rezultat i panaiereve të vazhdueshme, vizita studimore, trajnime dhe monitorim të vazhdueshëm, fermerët e "Teqes" tani janë më të organizuar duke punuar si grup dhe më konkurrues në treg. ●



Terrene kodrinore – më të përshtatshmet për gështenjën e butë

Për ngritjen e pemishteve me gështenja të buta janë të mira terrenet kodrinore të formuara me shtresa silikati, si edhe toka ranore, pjellore, të thella dhe të shkrifëta. Gjatë ngritjes së pemishtes është e rëndësishme të përcaktohet sasia e gëlqeres në tokë. Me masa përmirësuese duhet të hiqet sasia e tepërt e gëlqeres, se të zvogëlohet në masën më të vogël.

Shkruan:
dipl. inxhi. agr. Llambe Kucinovski



Fruta e gështenjës përmban një përqindje të lartë të amidonit, sheqerit dhe materialeve të tjera të dobishme, vitamina dhe minerale, siç janë magnezi, kalciumi, fosfori dhe pothuajse të gjitha vitaminat e grupit B. Prandaj ajo përdoret në ushqimin e njeriut si e zierë, e pjekur, kurse në disa rajone më të varfra ajo përdoret si zëvendësim i miellit dhe patates.

Fruta e gështenjës përdoret në amvisëri dhe ëmbëltore për të bërë ëmbëlsira të ndryshme. Në Itali e përziejnë me miellin dhe me të bëjnë polenta nga e cila bëhen kulaçe ose biskota të cilat quhen necco.

Druri i gështenjës përdoret si lëndë ndërtimi, cilësia e të cilit mund të krahasohet me atë të dushkut. Gjatë lulëzimit të gështenjës ajo është kullotë e përkryer për bletët të cilat japin mjaltë me ngjyrë të çelur, aromë të fortë, por me shije pak më të hidhur. Gjethja e gështenjës mund të shërbejë si ushqim për delet dhe dhitë, kurse përdoret si shtresë nëpër stallat.

Më tepër i përshtaten toka të formuara me shtresa silikati. Gështenja rritet edhe në toka ku vlera e pH-së është 4,5. Në disa rajone në Maqedoni, Mal të Zi dhe Greqi shtresa e silikatit ku rritet gështenja nuk ka shumë aciditet, por neutrale me aciditet të dobët. Gështenja rritet edhe në toka gëlqerore të cilat përmbajnë sasi të mëdha kaliumi.

PËRZGJEDHJA E TRUALLIT

Për ngritjen e pemishteve me gështenja të buta janë të mira terrenet kodrinore të formuara me shtresa silikati, si edhe toka ranore, pjellore, të thella dhe të shkrifëta. Gjatë ngritjes së pemishtes është e rëndësishme të përcaktohet sasia e gëlqeres në tokë. Me masa përmirësuese duhet të hiqet sasia e tepërt e gëlqeres, se të zvogëlohet në masën më të vogël.

Gështenja e butë po bëhet një kulturë gjithnjë dhe më e rëndësishme sepse mbetet në të njëjtin vend ku është mbjellë edhe 100 vjet. Prandaj duhet të kihet kujdes gjatë përzgjedhjes së vendit dhe truallit.

Gështenja e butë duhet të mbillet në rajone jugore, juglindore dhe lindore në kushte kontinentale.

Përveç faktorëve të tjerë, gjatë ngritjes së pemishtes nevojitet t'i kushtohet vëmendje edhe pjerrësisë së terrenit. Pjerrësia më e përshtatshme e tokës për ngritjen e pemishtes duhet të jetë 4-6 gradë.

Gështenja shumohet në mënyrë gjenerative dhe vegetative. Shumimi gjenerativ është farë, mbirja e farës zgjat maksimum 6 muaj, por më mirë është të mbillet menjëherë pas pjekjes, d.m.th. në tetor.

Mënyra vegetative e shumimit është me kalem. Gështenja e kalëmuar jep prodhim më shpejt, kurse frutat janë më cilësorë dhe më të mëdha. Kalemimi mund të bëhet me bashkim dhe nën kore.

Rekomandohet të përdoren plehra si sulfat amoni, nitrat kaliumi dhe sulfat kaliumi. ●



Guida teknike e zbatuar për prodhimin e integruar të mollës në Korçë, Shqipëri



Ky lloj prodhimit të mollës ka shumë përparësi dhe është i domosdoshëm që të sigurohen të ardhura të rregullta dhe me cilësi të lartë me përdorim minimal të kemikaleve, gjithashtu është e rëndësishme materiali për mbjellje është i certifikuar si i shëndetshëm dhe pa prani të sëmundjes, nga organi zyrtar.

Shkruan: Tomi Pikuli, Drejtori Ekzekutiv i Fondacionit Shqiptar

Ky dokument përcakton minimumin e standardeve dhe të direktivave për prodhimin e integruar të mollës në Korçë, Shqipëri. Kjo Guidë Teknike për Prodhimin e Integruar të Mollës u krye në konsultë me CABl-in Zviceran (www.cabi.org) dhe bazuar në të dhënat internacionale të Guidës Teknike për Prodhimin e Integruar. Përkufizimi për Prodhimin e Integruar ishte si në vazhdim: "Një sistem ferme që prodhon ushqim me cilësi të lartë duke përdorur burime natyrore dhe një mekanizëm rregullator që zëvendëson prodhimet e ndotura dhe siguron qëndrueshmëri të fermave. Komponentë esenciale janë ruajtja dhe vlerësimi i pjellorisë së tokës, si dhe shumëllojshmëria e mjedisit. Metodat biologjike, teknike dhe kimike janë balancuar me kujdes duke mbajtur për bazë ruajtjen e mjedisit, përfitimin dhe kërkesat sociale". Prodhimi i Integruar i Mollës kishte si objektivat e mëposhtme:

- përmirësimin e prodhimit të mollës që respekton mjedisin dhe është ekonomikisht i zbatueshëm;
- sigurimin e një prodhimi mollësh i shëndetshëm dhe me cilësi të lartë me minimumin e trajtimeve me pesticideve;
- ruajtjen e shëndetit të fermerëve gjatë trajtimit agrokimik;
- mbajtjen e një biodiversiteti biologjik të lartë në ekosistemin e pemëtores dhe në zonat rreth saj;
- dhënien e prioritetit të përdorimit të mekanizmave rregullues natyrorë;
- ruajtjen për një kohë sa më të gjatë të pjellorisë së tokës;
- minimizimin e ndotjes së ujit, tokës dhe ajrit.



Qëllimi i kësaj guide teknike ishte të krijohet dhe konservohej një mjedis i pemtores i balancuar dhe natyror me ekosistem të ndryshëm të bimëve dhe kafshëve. Ishte një nga burimet natyrore më të mëdha të fermës për të minimizuar përdorimin e pesticideve sepse insektet e dobishëm, të cilët janë të rëndësishëm në kontrollin e dëm-tuesve në pemët e mollës, mund të varen nga burimet që ata gjejnë në zonat e papunuara.

Ishte e rëndësishme për t'u përmendur që jo më pak se 5% e të gjithë sipërfaqes së pemtores (përfshirë edhe pyjet) duhet të menaxhohej si infrastrukturë ekologjike, pa përdorimin e pesticideve dhe të plehrave kimike, me qëllim që të rritet biodiversiteti biologjik. Gjithashtu me rëndësi ishin dhe zonat e amortizimit dhe e zbutjes të cilat tregojnë që në mbjelljen e pemëtoreve të reja, zona e amortizimit ose e zbutjes, nga pemët e bashtës deri tek zonat pa pemë (p.sh. liqene, përrenj, rrugë etj.) të mos jetë më pak se 3 metra (e pranueshme dhe më e gjerë).

Një tjetër pikë e rëndësishme e kësaj guide teknike ishte dhe zgjedhja e fushës, e cila kërkonte vetëm fusha të përshtatshme për të ndërtuar pemëtore të reja për të dhënë një prodhim me cilësi të mollës, fusha duhet të zgjidhet me aspekte dhe kushte të favorshme (p.sh. fushë jo acide, jo e ekspozuar ndaj mjegullës dhe lagështisë) të shman-gen situatat ku rreziku i sëmundjeve dhe dëmtuesve është i lartë dhe ku përdorimi i agrokimikateve ishte i vazhdueshëm. Kjo pikë lid-



hej gjithashtu dhe me menaxhimin e fushës qëllimi i të cilës ishte që të ruhej një diversiteti i specieve të bimëve dhe pjelloria e tokës në bashtë. Në këtë mënyrë sigurohej stabilitet ekologjik dhe parandalohet erozioni i tokës ndërkohë që minimizohej përdorimi i plehrave kimikë dhe i ujitjes. Nuk lejohej mbjellja e tokës midis rreshtave të pemëve më bimë të tjera gjithashtu, nuk lejohej pushtimi i tokës nën pemë nga barërat. Ishte rreptësisht i palejueshëm përdorimi i herbi-cideve dhe dizifektimi kimik i tokës.

Duke vazhduar më pas me zgjedhjen e varietetit/kultivarit, fidanëve dhe kultivimin e tyre ku të gjithë fermerët rekomandoheshin fuqimisht që të kërkonin këshillën e ekspertëve përpara se të zgjedhin kultivarin/varietetin për të mbjellë në një pemëtore të re, kështu që kjo rregullon një prodhim me cilësi të lartë dhe me një minimum shpenzimesh për punimet agrokimike. Gjithashtu, për sa u përket fidanëve ishte e rëndësishme që të gjitha materialet bimore të mbjella duhet të ishin të certifikuara nga një zyrë autoritare për shëndetin dhe

pastërtinë nga sëmundjet. Certifikata duhet të mbahej nga prodhuesi dhe të ishte e gatshme gjatë një inspektimi në fermë. Dhe në fund procesi i kultivimit duhet të ishte i rregullt duke filluar me trajtimet dhe të krasiten gjatë sezonit të dimrit sipas kërkesave të varietetit dhe sistemit të kultivimit, gjithashtu dhe krasitja e gjelbër (gjatë verës) ishte e rekomandueshme (p.sh. në pemëtoret e reja dhe në ato në rritje) dhe në situata ku krasitja dimërore nuk ka qenë e suksesshme. Rrallimi i frutave duhet të realizohej kur ishte i nevojshëm me qëllim që të sigurohej një prodhim me cilësi të lartë, me sa më pak përdorime kimikatesh.

Ky artikull përfshiu disa nga çështjet e para të guidës teknike të zbatuar për prodhimin e integruar të mollës në Korçë, në numrin tjetër të revistës ky artikull do të kompletohet dhe me pikat e tjera të kësaj guide teknike. ●

**Përgatitur nga Tomi PIKULI,
Drejtor Ekzekutiv i Fondacionit
AgriNet Albania.**

Ndikimi i mushamave të p mbi dritën, temperaturën dh

Mësoni se cilat janë dallimet, përparësitë dhe mangësitë e përdorimit të mushamave të bardha, bardhezi, të zeza, të tejdukshme, mushamatë me ngjyrë si edhe mushamatë ngjyrë argjendi të ndritshme dhe përzgjidhni ngjyrën përkatëse të mushamasë për rritjen e drejtë të kulturave tuaja, por edhe për parandalim të suksesshëm të barërave të këqija.



Shkruan: prof. dr. Zoran Dimov

Marrë nga broshura MBULIMI SI MASË AGROTEKNIKE NË PRODHIMIN E KOPSHTARISË

Mushamatë jopërzgjedhëse (të cilat e lejojnë kalimin e rrezeve infra të kuqe) më shpesh janë të zeza, pa ngjyrë, ngjyrë argjendi të ndritshme pse me dy ngjyra – bardhezi. Ekzistojnë shumë mushama me ngjyra të tjera si: të verdha, të kaltra, të kuqe dhe të gjelbra, por përdorimi i tyre është shumë i vogël (Figura 8). Edhe pse fitimet nga përdorimi, konkretisht i mushamave të kuqe në prodhimin e domateve janë evidente (Decoteau et. al., 1989) mushama të veçanta mundësojnë kalim më të madh të dritës që ndikon mbi rritjen intensive të barërave të këqija. Fakti që lejojnë prani më të madhe të barërave të këqija si edhe çmimi më i lartë i kostos, e kufizojnë përdorimin e tyre.

Siç edhe pritet, mushamatë e tejdukshme karakterizohen nga mbartje më të madhe (prej 84%) dhe absorbim prej minimum 5% të rrezeve të dritës me gjatësi të shkurtër të valës (Ham et al., 1993). Njëkohësisht, mushamatë e tejdukshme reflektojnë deri në 88% të rrezeve të dritës me gjatësi të madhe të valës, duke e ngritur temperaturën e truallit nga 4.4. deri në 7.800C matur në 5 cm thellësi të sipërfaqes së tokës (Lamont et

al. 1993). Nga ana tjetër aftësia e mushamave të tejdukshme të ndikojnë pozitivisht mbi ngrohjen e tokës varet shumë edhe nga mënyra se si përdoren ato, këto mushama e lejojnë të kalojnë rrezet me gjatësi të shkurtër të valës, kurse nuk i lejojnë të kalojnë rrezet me gjatësi të gjatë të valës. Kur ato nuk janë të vendosura fort mbi sipërfaqen e tokës, rrezet me valë të gjatë të cilat emitohen nga toka mbeten të "mbyllura" nën mushama, duke krijuar kushte siç janë ato në sera (Ham et al., 1993; Lamont, 1993; Liakatas et al., 1986). Në të kundërt nëse mushamatë e tejdukshme vendosen në mënyrë ideale, atëherë transmisioni i ngrohtësisë së truallit është më i vogël, kështu që dhe rritja e temperaturës së truallit është më i vogël (Ham and Kluitenberg, 1994; Ham et al., 1993).

Ndryshimet e temperaturave ditore, gjithashtu, ndikojnë mbi temperaturën e truallit ku mushamatë janë vënë si duhet (të përforcuara mirë edhe në gjatësi edhe në gjerësi)

si) në krahasim me atë kur ato vetëm janë vendosur sa për të mbuluar sipërfaqen e tokës (Tarara, 2000). Gjithashtu, përvojat kanë dëshmuar se efekti i ngrohjes së mushamave të tejdukshme në krahasim me mushamatë me ngjyra është mjaft më e vogël në kushte kur koha është e vrenjtur, si edhe në hapësirat me rrezatim më të vogël diellor (Johnson & Fennimore, 2005)

Efekti i madh i përdorimit të mushamave plastike të tejdukshme është në drejtim të solarizimit të truallit. Kjo është procedurë ku energjia e rrezeve të diellit, nëpërmjet ngrohjes së mbulesës e ngroh tokën deri në atë shkallë me çka shkaktohet degradim termik i bakteve, viruseve, nematodeve dhe farërat e barërave të këqija (Katan, 1981b; Katan and DeVay, 1991, Rusevski, 2013, komunikime personale). Në këtë drejtim, nga raportet e Kalifornisë janë marrë të dhëna sipas të cilave temperatura e truallit nën mushama të tejdukshme, në 5 cm thellësi ka arritur



Fig. 1. Prodhimi i pjeprit në mushama të kaltra, të kuqe dhe ngjyrë kafe (Fotografi e dr. Xhon Strang (Dr John Strang) nga Universiteti në Kentakili)

apërzgjedhura me ngjyrë e rritjen e barërave të këqija

të ngrohet deri në 6000C (Katan, 1981a; Katan, 1981b). Për këtë qëllim mushamatë plastike të tejdukshme mund të vendosen edhe pak më lirë mbi sipërfaqen e truallit çka do të ndikojë në ngritjen e temperaturës në hapësirën midis truallit dhe mushamasë. Që të shkaktohet efekti i ngrohjes intensive të truallit, mushamatë plastike të tejdukshme duhet të jenë të ekspozuara ndaj ndriçimit intensiv dhe temperaturës për një periudhë kohore më të gjatë, prandaj përdorimi i tyre në kushte të klimës më të ftohtë është i kufizuar (Katan and DeVay, 1991).

Edhe pse mushamatë e tejdukshme kanë efekt pozitiv në solarizimin e truallit, përdorimi i tyre vetëm si mbulesa është pothuajse shumë i kufizuar. Janë regjistruar të ardhura të mëdha nga luleshtrydhet (*Fragaria* sp.) gjatë përdorimit të mushamave të tejdukshme, por në kombinim me preparate për dezinfektim të truallit siç është metili i bromit (Johnson & Fennimore, 2005). Meqenëse përdorimi i metilit të bromit është i ndaluar, kurse nga ana tjetër nuk ekziston zëvendës përkatës i tij (Arsov, 2013, komunikime personale), mundësia për kontroll të barërave të këqija nën mushamatë e tejdukshme është mjaft e kufizuar. Në truaj ku nuk bëhet dezinfektim, mushamatë e tilla kontrollojnë vetë 65% të barërave të këqija në krahasim me mushamatë e zeza (Johnson & Fennimore, 2005). Prej kënde, mushamatë e tejdukshme nuk janë të mira si mbulesa vetëm nëse nuk përdoren në kombinim me herbicidet ose dezinfektuesit për kontroll shtesë të popullatës së barërave të këqija (Lamont, 2005).

Mushamatë e zeza plastike janë mbulesat më të përdorura në prodhimtarinë e kopshtit. Midis të tjerash, popullarizimi i tyre i dedikohet edhe çmimit të ulët të koston për njësi të sipërfaqes në krahasim me llojet e tjerave të mushamave, por edhe efektit pozitiv që e kanë në ngrohjen e truallit duke e përmirësuar prodhimin e kulturës përkatëse, si edhe në veprimin dhe efektin që kanë në shkatërrimin e barërave të ndryshme të këqija. Për dallim nga mushamatë e tejdukshme ato të zezat i absorbojnë pothuajse të gjitha rrezet

me valë të shkurtër duke siguruar ngrohje të truallit (Ham et al., 1993). Vendosja e tyre ideale gjatë së cilës realizohet kontakt i njëtrajtshëm me sipërfaqen e tokës është parakusht i domosdoshëm për zmadhimin e temperaturës së tokës (Lamont, 1993; Tarara, 2000). Me absorbimin e pothuajse të gjitha rrezeve me valë të shkurtër, temperatura në sipërfaqen e mushamasë mund të arrijë edhe deri në 5500C (Tarara 2000). Në kushte të tilla, temperatura në tokë në 10 cm nën mushama mund të rritet për 3-500C (Ham et. al.,

1993). Gjatë vegjetacionit, kur ndonjë prej kulturave të kopshtarisë do të përparojë me zhvillimin e vet, ajo shkakton hijezim në mushama dhe temperatura nën mushama bëhet disa gradë më e ulët që realisht është në të mirë të kulturës, në krahasim me situatën kur ajo kultivohet në tokë të pambuluar. Edhe pse farat e barërave të këqija nën mushama mund të mugëllojnë, zhvillimi i tyre i mëtejshëm është ndalur. Prej kënde ky lloj mushamash është zgjidhje ideale për prodhimin e hershëm në kopshtari.



Lloje të mushamave sipas ngjyrës:

MUSHAMA TË ZEZA – Ekonomike, sigurojnë mbrojtje prej barërave të këqija dhe ngrohje të tokës.

MUSHAMA TË BARDHA – Nuk sigurojnë mbrojtje të mira nga barërat e këqija. Rekomandohet në rajone ku është jashtëzakonisht nxehtë.

MUSHAMA BARDHEZI – Sigurojnë tokë më të ftohtë dhe mbrojtje më të mirë nga barërat e këqija sesa mushamatë e bardha.

MUSHAMA TË ZEZA-ARGJEND – E reduktojnë popullatën e insekteve të caktuara, ballafaqohen me sukses me barërat e këqija.

MUSHAM TË TEJDUKSHME – Të përshtatshme për solarizim të tokës.

MUSHAMA TË KUQE – Ndikojnë mbi zmadhimin e prodhimit tek kultura të caktuara të kopshtarisë.

Mushamatë me dy ngjyra - e bardhë me të zezë dhe mushamatë gri reflektuese përdoren më pak në krahasim me mushamanë e zezë, por ato ende luajnë një rol të rëndësishëm në sistemin e prodhimtarisë në kopshtari nëpërmjet zmadhimit të prodhimit dhe shkatërrimit të barërave të këqija. Gjatë periudhës së vegjetimit kur temperatura e tokës zmadhohet, ngrohja e tokës e cila ka mushama të zeza mund t'i dëmtojë bimët dhe të ndikojë theksueshëm në zvogëlimin e prodhimit. Me qëllim që të tejkalohen dëmet mbi kulturat, por nga ana tjetër të kihet ende kontroll mbi llojet e ndryshme të barërave të këqija, janë futur mushamatë e bardha dhe të argjenda reflektuese. Pa përdorim të dezinfektuesve, mushamatë e bardha janë mjaft joefikase në shkatërrimin e barërave të këqija sepse lejojnë depërtimin e më tepër drite, madje deri në 48% të rrezatimit të dritës (Ngouajio and Ernest, 2004). Me qëllim që të shfrytëzohet efekti pozitiv i mushamave të bardha dhe të zeza, janë krijuar mushamatë dyngjyreshe bardhezi, me të cilat kontrollohen me efikasitet barërat e këqija, kurse njëkohësisht nuk lejohet ngrohja e tepërme e truallit si rezultat reflektimit të rrezeve me ngjyrë të bardhë (Fennimore, 2005). Mushamatë bardhezi dhe të argjenda reflektojnë 48% përkatësisht 39% të rrezeve me valë të shkurtër. Reflektimi i tillë mund të shkaktojë ulje të lehtë të temperaturës në zonën e sistemit rrënjor në tokat ku janë të vendosura mbulesat e tilla krahasuar me tokën e zbuluar (Diaz-Perez, 2010; Diaz-Perez et al., 2005; Ham et al., 1993; Tarara, 2000). ●



Nevojitet drita dhe toka pjellore

Meli është bimë e ditës së shkurtër, ka nevojë për shumë dritë dhe nuk duron hijen. Menjëherë pas melekues, meli është bima më rezistente ndaj thatësisë, mund të durojë thatësi deri në një muaj e gjysmë dhe pastaj të vazhdojë me rritjen. Megjithatë, për zhvillim dhe rritje normale ka nevojë për sasi të mjaftueshme uji, prandaj reagon mirë ndaj ujitjes. Më mirë rritet në toka të thella, pjellore dhe të strukturuar me reagim të dobët deri në neutral të aciditetit.

Shkruan:

dipl. inxhi. agr. Rankica Bozhinoska

Meli e ka prejardhjen nga India dhe është një nga bimët më të lashta. Ai është i pasur me hekur dhe magnez që është shumë e rëndësishme për personat anemikë, kurse përbërja e tij minerale ndikon pozitivisht mbi funksionimin e sistemit nervor. Kokrra përdoret në ushqimin e kafshëve shtëpiake, para së gjithash, për ushqim të shpezëve dhe zogjve shtëpiake. E gjithë bima mund të përdoret për ushqim të bagëtisë si në gjendje të thatë ashtu edhe të njomë. Kokrra në industri mund të përdoret për prodhim të alkoolit dhe birrës.

VETITË BIOLOGJIKE DHE MORFOLOGJIKE

Sistemi i rrënjës tek meli është i ndërtuar njëjtë si tek drithërat e tjera - një rrënjë parësore e cila degëzohet dhe ka më tepër degë dhe degëza. Arrin thellësi deri në një metër dhe ka fuqi të madhe thithëse. Kërçelli është me qime të vogla dhe mund të arrijë lartësi 70 deri në 100 cm. Fruta është kokërr me ngjyrë të verdhë - pesha 1000 kokrra peshojnë 4-8 gram, kurse pesha në hektolar është 70-75 kg. Vegjetimi zgjat 60-20 ditë.





AGROTEKNIKA E PRODIMIT TË MELIT

PJELLORIA E TOKËS

Parakultura të mira janë përzierjet e mashurkave, ato me rrënjë të thella dhe barëra të ndryshme, kështu që mund të rritet me sukses në kullota dhe livadhe të lëruara. Meli është parakulturë e mirë për shumë kultura bujqësore dhe mund të mbillet si kulturë e dytë dhe e tretë gjatë një viti.

PËRPUNIMI I TOKËS

Shtresa sipërfaqësore duhet të jetë e imët dhe e përgatitur mirë sepse fara e melit mbillet në sipërfaqe me thellësi të vogla. Në një sipërfaqe mesatare pjellore duhet të hidhen 100 kg/azot, 130 kg/fosfor dhe rreth 90 kg/kalium.

Për kulturë të dytë, sasia e plehrave duhet të zvogëlohet me 1/3.

KUJDESI PËR TË MBJELLAT

Pas mbjelljes duhet të ketë kontakt të mirë midis farës dhe tokës. Nëse prej mbjelljes deri në mbirje bëhet një kore me shtypje do të lehtësohet mbirja. Zhvillimi dhe rritja fillestare e melit janë të ngadalshme, prandaj barërat e këqija mund ta tejkalojnë lehtë dhe ta mbyllin melin, prandaj është e nevojshme kohës pas kohe të hiqen barërat e këqija. Nëse mbjellja është me radhë trualli duhet të kultivohet.

MBJELLJA E MELIT

Mbjellja bëhet me mbjellëse në reshta në largësi prej 10-12 cm ose në largësi më të madhe, 20-30 cm. Sasia e farës mund të lëvizë 15-25 kg/ha. Thellësia e mbjelljes

lëviz nga 2 deri në 4 cm. Meli kryesisht mbillet në gjysmën e parë të muajit maj, ku temperatura e truallit është mbi 12 gradë.

KORRJA DHE MAGAZINIMI

Zakonisht piquet në mënyrë jo të njëtrajtshme, kurse korrja bëhet me kombajnë dhe rendimenti mund të arrijë 3t/ha farë. Tharja, magazinimi i farës kryhet në mënyrë të njëjtë si edhe tek gruri. Në gjendje të thatë kokrrat mund të ruhen për një kohë më të gjatë sepse nuk mund të zhvillojë myk që është me rëndësi për ruajtjen e vlerës ushqyese të melit. Ekzistojnë lloje të ndryshme të makinerive për tharje si ato me ajër të ngrohtë ose me gazra të ngrohta të cilat e thajnë kokrrën me lagështi mbi 16%. Tharja nuk duhet të kryhet në temperaturë mbi 40%.



Meli është i përshtatshëm për kushtet e Maqedonisë. Temperatura mesatare gjatë periudhës së vegjetimit duhet të jetë mbi 15 gradë, sepse nën këtë temperaturë rritja dhe zhvillimi i melit ngadalësohet. Është e përshtatshme gjatë vegjetimit temperatura të jetë mbi 20-25 gradë. Meli është bimë e ditës së shkurtër, ka nevojë për shumë dritë dhe nuk duron hijen. Menjëherë pas melekukes, meli është bima më rezistente ndaj thatësisë, mund të durojë thatësi deri në një muaj e gjysmë dhe pastaj të vazhdojë me rritjen. Megjithatë, për zhvillim dhe rritje normale ka nevojë për sasi të mjaftueshme uji, prandaj reagon mirë ndaj ujitjes. Më mirë rritet në toka të thella, pjellore dhe të strukturuar me reagim të dobët deri në neutral të aciditetit. ●



MJALTË që rrjedh nëpër çezmë drejtpërdrejt nga kornizat

Me shpikjen e jashtëzakonshme harrojeni mbledhjen e lodhshme dhe tradicionale të mjaltit, e cila merr shumë kohë. Kjo mënyrë e re është më e lehtë si për bletarët ashtu edhe për bletët.

Shkruan: Monika Risteska

Njerëzit kanë evoluar së bashku me bletët dhe me to kanë një lidhje të pandashme. Ne kujdesemi për to, ato i pllenojnë kulturat tonë dhe gjithsesi na japin edhe shumë mjaltë të shijshme. Por, mbledhja e “nektarit të artë” ka qenë gjithmonë një detyrë e komplikuar.

“Unë vendosa se është e mundimshme që çdo herë të hapet kosherja, të nxirren kornizat, pastaj të jenë nën stres të gjitha bletët dhe të kalojë një ditë e tërë me kosheret që të mbledhet mjalti. Unë mendova se duhet të ketë ndonjë mënyrë më të mirë. Prandaj, së bashku me tim atë e zbluam këtë mënyrë.” – thotë i biri, bletar, një prej dy shpikësve gjenialë të koshereve rrjedhëse për bletë.

Dhe ne e kryem këtë Tani thjesht e vërtit rubinetin e çezmës dhe mjalti i pastër dhe i freskët rrjedh nga kosherja direkt në kavanoz. I shijshëm dhe i gatshëm për të ngrënë.” – deklaron babai, bletari, gjenial.

Kur shpikësit Sidar Anderson dhe i ati i tij Stjuart e shpallën dizajnin e tyre të ri radikal për koshere në platformë për mbledhjen e donacioneve “Indiegogo” në fund të shkurtit, ata





shpresonin se do të mblidhnin 70 mijë dollarë. Tetë javë pas mbylljes së kësaj fushate, ata arritën të mblidhnin një shumë mbresëlënëse prej 12 milionë dollarësh amerikanë.

Kjo familje prej pyjeve me shira në brendësi të Bajron Bej në bregun e largët verior të Uellsit të Ri Jugor ka kaluar më tepër se një dekadë në krijimin e një sistemi brilant të thjeshtë, por megjithatë revolucionar, i cili do t'u mundësojë bletarëve të mbledhin mjaltë me ndihmë të çezmës, pa hapje të kosheres së bletëve dhe pa shqetësuar shoqëritë e bletëve. Ky sistem përbëhet nga korniza të cilat janë prej plastike, në të cilat qelizat e huallit janë të prera në mes. Kur hualli është plot me mjaltë, me rrotullim të rubinetit struktura e brendshme ndryshon, d.m.th. qelizat hapen duke formuar hapen duke formuar një kanal nëpër të cilin kalon mjaltë dhe del jashtë prej kosheres. Pasi të rrjedhë mjaltë, hualli vendoset në pozitën fillestare dhe duke e rrotulluar rubinetin kornizat janë gati



për t'u mbushur përsëri me mjaltë nga bletët. Në këtë mënyrë mbledhja e mjaltit është më e këndshme jo vetëm për bletët por edhe për bletarët, sepse ata tani nuk do ta humbin kohën dhe mundin si gjatë mbledhjes tradicionale të mjaltit.


Reagimi global është mbresëlënës. Më tepër se 35 mijë njerëz kanë investuar në projektin “Koshere rrjedhëse”. Në afat prej tri orësh, ata kanë arritur të mbledhin 1 milion dollarë. Ky projekt është projekti më i madh për mbledhjen e donacioneve në “Indiegogo” deri më sot.

“Vizioni ynë për bashkësinë e bletarëve të cilët e përdorin shpikjen tonë, të cilët do të jenë të bashkuar me dashurinë për bletët dhe me kuptimin më të thellë të botës natyrore, tashmë nuk është më vetëm ide”.

Ai vlerëson se rreth 50% e njerëzve të cilët kanë investuar në “Koshere rrjedhëse” janë të rinj në këtë fushë.



Edhe pse shpikja gjeniale që ua ka ndryshuar jetën është gati, babai dhe biri Anderson ende nuk mund të pushojnë, sepse tani presioni është përsëri mbi ta. Ata duhet të arrijnë t'i realizojnë të gjitha porositë. Këto koshere prodhohen në Brizbejn, kurse mandej transportohen nëpër të gjithë botën. Ndërkohë që prodhimi pritet të vazhdojë gjatë vitit 2016, familja Anderson, gjithashtu, po punon në ndërtimin të bashkësisë së bletarëve onlajn që t'i rrjetësojë pronarët e koshereve rrjedhëse të shpikura prej tyre. ●





USAID
FROM THE AMERICAN PEOPLE



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra
Swiss Confederation
Federal Department of Economic Affairs,
Education and Research EAER
State Secretariat for Economic Affairs SECO

**PROJEKT PËR ZGJERIM
TË BIZNESEVE TË VOGLA**

Kërpudhat e egra – delikatesë e cila sjell fitim të mirë

Prej shumë kërpudhave që blihen komercialisht në Maqedoni, vetëm njëra mund të thuhet se e mban primatin si burimi kryesor dhe më të madh të të hyrave të mbledhësve, pikave blerëse dhe eksportuesve në Maqedoni - kërpudha e malit. Çmimi i kërpudhave të malit këtë sezon ka qenë deri në 170 denarë për kilogram. Nëse një mbledhës mesatarisht shet të paktën 200 kilogram kërpudha mali në pikën lokale të blerjes, ai mund të fitojë përafërsisht 34.000 denarë gjatë muajit, shumë të hollash e cila është e mirëseardhur në çdo amvisëri.

Shkruan: Atanas Dimitrov

Gjatë vjeshtës, një numër i madh adhuresish të natyrës i vizitojnë pyjet nëpër gjithë Maqedoninë. Në shtator dhe tetor, me daljen e kërpudhave të vjeshtës dalin edhe mbledhësit e kërpudhave. Të freskëta ose të marinuara, në zgarë apo në rizoto, kërpudhat e pyllit janë delikatesë e vërtetë për njohësit e mirë të tyre. Një pjesë e tyre i mbledhin për qejfin e vet dhe që t'u japin miqve të vet. Një numër i madh mbledhësish punojnë komercialisht dhe kërpudhat i shesin në disa pika blerëse të cilat janë në territorin e të gjithë vendit. Nga dita në ditë, shportë pas shporte, shumë familje thonë se mbledhësit e kërpudhave dhe prodhimeve të tjera të egra i kanë ndihmuar të shkollonjë fëmijët e vet dhe të kenë një jetë të mirë. Vlerësohet se mbi 50.000 në Maqedoni merren me mbledhjen e kërpudhave dhe prodhimeve të tjera të egra. Këtë vit kushtet e motit dhe sezoni i vjeshtës ishte më dobët se zakonisht, por mbledhësit këmbëngulës megjithatë arritën të kenë fitim solid. Prej shumicës së llojeve të kërpudhave që blihen komercialisht në Maqedoni, vetëm njëra mund të thuhet se e mban primatin si burimi kryesor dhe më të madh të të hyrave të mbledhësve, pikave blerëse dhe eksportuesve në Maqedoni - kërpudha e malit. Çmimi i kërpudhave të malit këtë sezon ka qenë deri në 170 denarë për kilogram. Nëse një mbledhës mesatarisht shet të paktën 200 kilogram kërpudha mali në pikën



lokale të blerjes, ai mund të fitojë përafërsisht 34.000 denarë gjatë muajit, shumë të hollash e cila është e mirëseardhur në çdo amvisëri. Përveç asaj se kërpudhat janë të vlefshme për mbledhësit, ato janë pjesë e rëndësishme e tregtisë së Republikës së Maqedonisë - eksporti i kërpudhave në nivel vjetor ka qenë rreth 10 milionë dollarë në vitin 2012.

Një prej sfidave kryesore për mbledhjen e kërpudhave është që ato të mbrohen nga mbledhja jashtë mase dhe e pakujdesshme - nëse nuk kihet kujdes që të mundësohet riprodhimi i vazhdueshëm i kërpudhave ato mund të zhduken tërësisht në rajone të caktuara. Edukimi i rregullt dhe përfaqësimi në dobi të mbledhjes së qëndrueshme janë sidomos të rëndësishme në vende si Parku Nacional i Mavrovës, ku fokusi pri-

mar është të ruhet biodiversiteti dhe të mbrohet mjedisi natyror. Personat profesionalë vlerësojnë se vlera e kërpudhave komerciale dhe prodhimeve të tjera pyjore të cilat mund të mbledhen në territorin e këtij parku arrin shumën deri në 50 milionë dollarë në vit. Me qëllim që të përkrahen përpjekjet e Parkut, por edhe të mundësohet që mbledhësit në territorin e tij të realizojnë të ardhura më të mëdha, Projekti i USAID-it për Zgjerim të Bizneseve të Vogla, i kofinancuar nga Qeveria Zvicrës, gjatë viteve të kaluara, ka mbajtur 12 trajnime në këtë territor që t'i trajnojnë dhe t'u japë certifikata mbledhësve lokalë të prodhimeve të malit për mbledhjen e prodhimeve të malit në territorin e tij. Përveç kësaj, Projekti i ndihmoi Parkut Nacional të ndërtojë kornizë normative për mbledhjen e prodhimeve të egra në territorin e tij.

Rregullat themelore për mbledhjen e kërpudhave

1. Nuk ekziston mënyrë 100% e sigurt për përcaktim të llojit të kërpudhave.
2. Njohja e kërpudhave kryhet duke përdorur literaturë të mirë, por edhe njohuritë e mbledhësve me eksperiencë.
3. Çdo paqëndrueshmëri dhe improvizim mund të paguhet me jetë.
4. Mblidhen vetëm ato kërpudha të cilat i njohim mirë dhe vetëm në sasinë e nevojshme.
5. Kërpudhat e reja dhe të pazhvil-luara nuk mblidhen sepse mund të ngatërrohen lehtë me llojet e kërpudhave helmuese.
6. Kërpudhat të cilat janë shumë të pjekura nuk mblidhen sepse nuk janë për konsum dhe është më mirë të mbeten në natyrë.
7. Kërpudhat helmuese nuk shkatërrohen sepse i nevojiten natyrës.
8. Kërpudhat mblidhen të gjitha, me kujdes që të mos dëmtohet miceliumi.
9. Prishja e shpejtë parandalohet vetëm me vendosjen e materialit të mbledhur në kuti druri dhe jo në qese najloni.
10. Kërpudhat pastrohen në vend (hiqen pjesët me krimba).
11. Pastrimi shtesë kryhet pa përdorim të ujit. Nëse është e domosdoshme të kryhet larja, ajo kryhet me ujë të ftohtë.
12. Te kërpudhat që rriten në grupe, duhet të lihen të paktën 20% të kërpudhave që të mundësohet ripërtëritja.
13. Gjatë mbledhjes lini gjithmonë disa kërpudha në vend që të mund të ripërtërihen.



Kërpudha e malit (*boletus edulis*) ose siç e quajnë ndryshe kërpudha e "ujkut" ose kërpudha porcini është kërpudha komerciale që haset më shpesh në pyjet tona dhe e cila eksportohet jashtë Maqedonisë. Rritet në pyjet gjethe gjilpërë, nga fillimi i verës deri në fund të vjeshtës. Në vjeshtë shfaqet në pyjet me pisha. Njihet nga trupi i madh i mishtë, i cili në çdo rast është më i gjerë se kapela. Në vend të gjetheve/lamelave si disa prej kërpudhave të njohura, kërpudha e malit ka vrima poroze nën kapele, nga e cila, kur është e pjekur bien sporet dhe pllenohet miceliumi. Mishi ka ngjyrë qumështi deri në kafe, në varësi nga pjekuria. Kapela është kafe e brishtë, në të kuqe.



Më 23 shtator 2015, USAID-i, në bashkëpunim me Parkun Nacional "Mavrovë" dhe Komunën e Mavrovë-Rostushe e ka shënuar hapjen e dy pikave të reja blerëse në Pillana dhe Jançe. Duke i përfshirë pikat e reja, në Parkun Nacional momentalisht funksionojnë tri pika blerjeje. I pari në Vërben është hapur në vitin 2014. Gjatë përgatitjeve për hapjen e pikave blerëse, USAID-i ka dhuruar pajisje me vlerë prej 5.000 dollarësh.

Me këto risi po futen ndryshime të cilat do ta mbrojnë më mirë biodiversitetin, por edhe mbledhësit në Park, për të cilët mbledhja është një nga burimet primare të të ardhurave. Me kornizën normative janë vendosur rregullat e sjelljes së mbledhësve dhe blerësve të cilët janë të interesuar për blerjen e kërpudhave dhe prodhimeve të tjera të egra në territorin e Parku. Mbledhësit të cilët duan të mbledhin komercialisht janë të obliguar të mar-

rin pjesë në trajnimin për mbledhje të qëndrueshme, të nënshkruajnë marrëveshje me një apo më tepër prej tri pikave të blerjes dhe të marrin lejë për mbledhje në territorin e Parkut Nacional. Vetëm në territorin e Parkut, janë trajnuar më tepër se 450 persona. Në territorin e të gjithë Maqedonisë janë trajnuar më tepër se 1.500 persona.

Projekti do të vazhdojë me mbajtjen e trajnimeve pa pagesë edhe në periudhën që vijon në Rajonin e Vardarit, Verilindor, Rajonin e Pelagonisë dhe të Pologut. Personat e interesuar mund të paraqiten për trajnim në këtë numër telefoni: (02) 3 215 744. Për më tepër informacione për llojet e prodhimeve të pyllit të cilat mund të mblidhen për shitje dhe për mënyrën e mbledhjes, merreni doracakun për mbledhjen e bimëve, likeneve, kërpudhave dhe frutave të pyllit në:

<http://bit.do/shumski-plodovi>.



Shkumës për blegtori – ushqim për gjedhët



Shkraun: dipl. agr. Jelica Beshliq

Materialet minerale të cilat u nevojiten kafshëve shtëpiake gjenden në të gjitha ushqimet, megjithatë në vaktet ditore ato zakonisht nuk i plotësojnë nevojat, sidomos nëse bëhet fjalë për kategoritë e reja të kafshëve, si dhe për gjedhët për shumim dhe qumësht. Gjatë përgatitjes së vakteve ditore për lloje dhe kategori të ndryshme kafshësh, së pari duhet të kihet parasysh me ushqimin të plotësohen edhe nevojat për energji dhe proteina. Nëse vaktet e tilla nuk përmbajnë sasi-në e nevojshme të materialeve minerale, atëherë ato shtohen në ushqim.

Shkumësi për gjedhe futen te foragjeret minerale. Foragjeret minerale janë bashkime organike dhe joorganike që përdoren për plotësim të nevojave të kafshëve me kalcium, natrium, magnez, fosfor etj. Vakti ditur, pa dallim se për cilin lloj kategorie e kafshe bëhet fjalë, përveç pjesës me proteina dhe energji, duhet të përmbajë edhe pjesë minerale. Shkumësi për gjedhë është karbonat kalciumi, i cili fitohet me bluarje të shkumësit, gëlqeres dhe mermerit. Përdoret që të balancohen vaktet në të cilat nuk ka kalcium të mjaftueshëm, si edhe për mbajtjen e ekuilibrit midis bazave dhe acideve ose të neutralizohet thartësira te disa ushqime, siç është silazhi.

Cilësia e kësaj shtese mineralesh më tepër varet nga lloji i gëlqerorës që merret nga bluarja. Mermeri i bluar është karbonat kalciumi më i pastër, kështu shkumësi i tillë është me cilësi më të mirë. Që të mund të përdoret shkumësi për gjedhë si ushqim për gjedh, ai nuk duhet të përmbajë më shumë se 2% ujë, 1% magnez dhe 1% përzjerje të tjera. Përmbajtja e kalciumit është 36%. Kalciumi është i domosdoshëm për ostifikim të koc-kave, për zhvillim të kontraksioneve të muskujve dhe ndikon pozitivisht

mbi koagulimin e gjakut. Deficiti i kalciumit çon në osteodistrofi dhe fibrozë. Përveç shkumësit për gjedhë, burim kalciumi janë edhe kullotet e gjelbra dhe kashta. Shkumësi për gjedhë shtohet shpesh te përzjerjet e

gatshme foragjere për ushqim të kafshëve shtëpiake. Përqendrimi varet nga lloji dhe kategoria e kafshëve dhe lëviz nga 0,5% deri në 9%. Për lopët qumështdhënëse shtohet më shpesh sasi prej 0,5% deri në 1% për vakt. •





Shkraun: dipl. agr. Jelica Beshliq

Kashta – materiali më i pranueshëm për shtresë

Në mjedisin tonë rrethues kashta është materiali më i pranueshëm dhe më i përdorur për shtresa, Ajo e thith lagështinë në mënyrë të përkryer dhe e ruan ngrohtësinë e kafshëve që mërzejnë. Një kilogram kashtë mund të thithë 3-4 litra lagështi. Sipas disa hulumtimeve është vërtetuar se një kilogram kashtë e grirë mund të thithë rreth 3,98 litra ujë, një kilogram kashtë e përpunuar nën presion thith 3,23 litra ujë, kurse kashta në gjendje të shkrifët thith 2,2 litra ujë.

Në të gjitha mënyrat dhe sistemet e rritjes së gjedhit përdoren sasi të mëdha për shtresë. Për shtresë mund të përdoren lëndë të ndryshme të para, siç janë: kashta, ashta me cilësi të dobët, misri i prerë, tallashi i drurit, rëra e të tjera. Si shtresë e mirë konsiderohet ajo që mbetet e thatë për një kohë më të gjatë dhe ka aftësi ta lidhë lagështinë. Është e rëndësishme shtresa të përshtatet me formën e trupit të kafshës kur ajo ri shtrirë. Nga aspekti higjienik, shtresa nuk duhet të ketë myk, si edhe numër të madh bakteresh se pse kur kafsha ri shtrirë, p.sh. lopa, bakteret e shtresës nëpërmjet majave të thithave futen në kanalën e qumështit ku mund të shkaktojnë pezmatim.

Nëse materiali për shtresë është më i imët ai përmban më shumë baktere, sidomos kur ka lagështi të zmadhuar. Nëse përdoret tallash si shtresë, është e dëshirueshme ai të jetë prej druri të butë, siç janë: pisha, bredhi, shelgu dhe plepi, kurse tallashi prej drurësh të fortë, si janë: dushku, ahu dhe shkoza anashkalohet sepse mund të shkaktojë lëndime.

Në shtresë mund të shtohet edhe karbonat kalciumi i thërrmuar (gëlqere e pashuar) me imtësi të grimcave prej 0,09 mm. Gëlqerja ka aftësi të lidhë lagështinë e shtresës. Me përzierjen e materialeve gëlqerore me shtresën zmadhohet vlera pH e shtresës, duke u zvogëluar kështu

zhvillimi i baktereve. Që të parandalohehen me sukses bakteret, vlera pH e shtresës duhet të jetë mbi 10.

Në mjedisin tonë rrethues kashta është materiali më i pranueshëm dhe më i përdorur për shtresa, Ajo e thith lagështinë në mënyrë të përkryer dhe e ruan ngrohtësinë e kafshëve që mërzejnë. Një kilogram kashtë mund të thithë 3-4 litra lagështi. Sipas disa hulumtimeve është vërtetuar se një kilogram kashtë e grirë mund të thithë rreth 3,98 litra ujë, një kilogram kashtë e përpunuar nën presion thith 3,23 litra ujë, kurse kashta në gjendje të shkrifët thith 2,2 litra ujë për kilogram. Përveç ujit, kashta ka fuqi të thithë edhe gazrat e dëmshme siç janë amoniaku dhe acidi sulfurik. Është vërtetuar se kashta prej drithërave dimërorë ka fuqi absorbuese më të madhe se ajo e drithërave pranverorë.

Sasitë optimale ditore të kashtës së përdorur për shtresë gjatë periudhës së dimrit janë nga 8 deri në 10 kilogram. Kur shtresa është më e trashë, ngrohtësia shtratit mbahet më gjatë, kurse kjo ndikon që të ketë produktivitet më të lartë. Në varësi nga sistemi i mbajtjes dhe llojit të shtratit, sasitë ditore të kashtës për kokë bagëti lëvizin nga 1 deri në 3 kg tek mënyra e lirë e mbajtjes, dhe deri në 10-18 kilogram tek sistemet me shtretër të thellë.●

Fuqia e absorbimit të lagështisë të disa llojeve shtresash në raport në % me masën e vet

Lloji i shtresës	Fuqia e absorbimit (% nga masa e vet)
Kashtë gruri	225
Kashtë tërshëre	213
Kashtë elbi	240
Tallash druri	350
Treset	600-1100

Më ekonomiku dhe më i përkryeri

Kur u shfaq Zetori Kristal 160 shkaktoi interes shumë të madh në mbarë tregun e Evropës. Ai është traktor kompakt i klasës së traktorëve të rëndë, me fuqi prej 160 KF. ZETOR KRISTAL 160 është model i ri traktori nga spektri i brendit Zetor, i cili ka nisur të prodhohet në fillim të vitit 2015 dhe ka marrë çmimin si më ekonomiku dhe më i përkryeri në klasën e tij.

I lehtë për manovrim, me motor të fuqishëm, me kabinë të gjerë dhe komode ku zhurma dëgjohet në minimum, ekonomik për mirëmbajtje dhe punë. Këto janë atributet që e bëjnë Kristal 160 të përkryer në të gjitha kushtet e punës. Motori është me gjashtë cilindra me fuqi prej 160 KF dhe falë rezervës së madhe të momentit të rrotullimit, nevoja për ndryshime të shpeshta të përcjellshmërisë është zvogëluar për 30%. Fuqia është konstante te rripi i gjerë i rrotullimeve, Ai ka marsh tërësisht të sinkronizuar me 30/30 shkallë të përcjellshmërisë. Boshti dalës është me 540/540E dhe 1000/1000E, kurse boshti i parë është me 1000 rrotullime. Hidraulika është me sistem për menaxhim hidraulik-elektronik Bosh që karakterizohet nga fuqia e madhe për ngritje dhe rregullimi preciz, duke përfshirë edhe funksionin e bllokimit të hidraulikës gjatë transportit.

Shkruan: Sashko Stoshij



KARAKTERISTIKA TEKNIKE

Zetor

MOTOR:

TIER III B	TCD 6.1 L6
Fuqia ISO 2000/25 (kW/KS)	120,1/160
Numri i cilindrave	6
Kompresori	P0
Vëllimi (cm³)	6057
Momenti i maks. rrotullimesh/rezerva (ECE 24) (Nm/%)	739 / 36

HIDRAULIKA:

Pajisje për bashkim "në tri pika"	Kategoria KAT III
Kapaciteti i hidraulikës (kg)	8670
Kapaciteti i pompës (l/min)	85

DIMENSIONE:

Pesha (kg)	5840
Gjatësia (mm)	4670
Gjerësia në rrotat e pasme (mm)	2550
Lartësia që nga tubi i gazrave (mm)	2970
Largësia midis boshteve (mm)	2840
Gomat e para	540/65R28
Gomat e pasme	650/65R38



1.400 EKSPozUES TAKOHEN ME MBI 200.000 VIZITORË NË PANAIRIN NË IZMIR, TURQI



www.agroexpo.com.tr

★ Hyrja e lirë në qendrën për ekspozim

★ Takime biznesi pa pagesë

- ★ mekanizim bujqësor dhe shfaqje rinovuese, koha për ekspozimin e modeleve të reja të traktorëve për 2016, trajnime dhe shfaqje për blegtorët, konkurse bukurie për bagëtinë, për lopët, delet dhe dhitë, konkurs bukurie për qentë Sivas kangall, panel-diskutime dhe seminare, gara dhe shpërblime të ndryshme.

Ju lutem na kontaktoni: international@orionfair.com

Mbështetësit tanë:



orion
FAIR
www.orionfair.com

Orion shërbime tregtare dhe marrëdhënie me publikun, kompani e inkuorporuar

Adresa e kompanisë: Onur Mahalesi Zambak Sokak nr. 21/ a Balkova – Izmir/ Turqi

Panairi: FUAR IZMIR – GAZIEMIR/ IZMIR - TURQI

Telefon: +90 555 800 49 37 (pbx) Faks: +90 232 277 39 04 E-mail: international@orionfair.com



Histori suksesi të grave rurale në Pukë

Gratë pukjane kanë aftësitë intelektuale dhe arsimin e nevojshëm për të qënë pjesë e vendimmarrjes, por nuk lejohen nga burrat dhe klanet që krijohen si nga partitë politike dhe shoqëria në përgjithësi.

Shkruan: dr. Vitor Malutaj

AKTIVITET SOCIAL-KULTUROR; "HISTORI SUKSESI TË GRAVE RURALE NË PUKË".

Në prag të mbylljes së vitit 2015, Agropuka organizoi me datë 22 dhjetor aktivitetin "Jo më peng i mentalitetit (Histori suksesi të grave pukjane), me qëllim nxjerrjen në dukje të kontributit që ka dhënë Agropuka për adresimin e çështjeve të barazisë gjinore dhe sfidave në të ardhmen për të adresuar këto probleme. Aktiviteti ishte i përberë nga 3 pjesë;

- Panair i prodhimeve të grupeve të grave të ngritura nga Agropuka;
- Reportazh me histori suksesi të grave pukjane; dhe
- Panel diskutimi; Arritjet, sfidat dhe ide për të ardhmen, për fuqizimin social ekonomik të grave.

Aktivitetin në të cilin merrnin pjesë mbi 70 gra nga të 8 grupet e grave të ngritura nga AP-ja, përfaqësuese të organizatave simotra nga rrethe të tjera, drejtues të dy bashkive të rrethit si dhe drejtues e përfaqësues të institucioneve publike të rrethit, e hapi Kryetarja e Shoqatës AP, znj. Marije Frroku, e cila pasi u uroi mirëseardhjen të pranishmeve i njohu ata me axhenden e këtij aktiviteti.

Në emër të Bashkive Pukë e Fushë-Arrës përshëndetën nënkryetarët respektiv Artan Zaja e Ndue Doda. Nënprefekti i rrethit zoti Marash Kola, në fjalën e tij përshëndetëse theksoi se problemet e integritimit gjinor janë të pandara si për gratë e zonave rurale edhe për gratë që jetojnë në dy qytetet Pukë e Fushë-Arrës dhe të tilla duhet të konsiderohen si nga shoqëria civile, pushteti lokal e ai qendror. Gjithashtu, zoti Kola theksoi se në barazinë gjinore aspekti numerik nuk është i rëndësishëm.

Në emër të Oxfam Italia me qendër në Shkodër, përshëndeti znj. Margarita Çuni, e cila vlerësoi arritjet e grave pukjane dhe në të njëjtën kohë premtoi se përvojën e tyre do ta çojë tek grupet e grave të Malësisë së Madhe dhe kërkoi rritjen e bashkëpunimit me grupet e grave të Shkodrës

Reportazhi me histori suksesi të grave pukjane i shfaqur për rreth 30 minuta solli përvojat e suksesshme në përpunim të grave të grupeve Gjeggjan, arritjet në mbarështimin e bletëve nga grupi i grave Qelëz, përvojën e grave të grupit Qerret në kultivimin e perimeve në serra, sukseset e grave të grupit Blerim në punime dore, veshje popullore dhe punimet me vekë si dhe përvoja të tjera të ngjashme nga grupet e grave në Iballë, Kryezi e Fushë-Arrës.

Në Panelin e Diskutimit; "Arritjet, sfidat dhe ide për të ardhmen, për fuqizimin social ekonomik të grave",



moderuar me shumë profesionalizëm nga gazetari i News 24, zoti Armir Mehaj, u ngritën shumë probleme e shqetësime të grave në Pukë, por edhe në të gjitha zonat rurale të Shqipërisë, si dhe u dhanë mendime, sugjerime e propozime për zgjidhjen e tyre si me poshtë:

1. Gratë në vendimmarrje zënë një përqindje shumë të vogël në rrethin e Pukës. Nga 30 anëtarë të këshillit në dy bashkitë e rrethit, vetëm 3 prej tyre ose 10 % janë gra, - theksoi zonja Marije Shkaj - ndërsa në të 74 fshatrat që ka rrethi të gjithë kryetarët e fshatrave (kryepleqtë) janë meshkuj.
2. Planifikimi dhe buxhetimi gjinor nuk realizohet nga pushteti lokal, sepse nuk organizohen takime me grupet e interesit të grave, por edhe ato pak takime e diskutime që realizohen bëhen vetëm me burrat, të cilët nuk i njohin njëllëj si gratë problemet shqetësuese të komunitetit. Shembujt që solën gratë në diskutimet e tyre e vërtetëtonin plotësisht këtë gjë.
3. Punësimi, dhe sidomos vetëpunësimi i grave në Pukë është në një shkallë shumë të ulët, dhe bile më të ulët se i burrave. Kjo ndodh për shkak se gratë në familje nuk i kanë kompetencat dhe nuk lejohen nga burrat të nisin veprimtari biznesi, sado të thjeshta qofshin ato. Gratë që ngritën këtë problem e vunë theksin tek roli më i madh që duhet të luaj shteti në këtë drejtim.
4. Mungesa e qendrave sociale, kulturore dhe argëtuese për gratë



ishite një problematike tjetër që u diskutua në këtë panel. Papunësia dhe marrja vetëm me punët brenda shtëpisë na ka izoluar dhe ne nuk kemi mundësi as të diskutojmë me njëra-tjetrën as për hallat tona dhe as për zgjidhjen e tyre - u shprehën gratë.

5. Shumë shqetësuese u konsiderua fakti se në shumë fshatra të Pukës gratë ngarkojnë në shpinë produkte ushqimore, ushqime për blegtorinë apo edhe dru zjarri me kilometra të tëra, për shkak të mungesës së infrastrukturës, sidomos rrugëve automobilistike.
6. Mungesa e këndeve të lojërave për fëmijë në qytetet e Pukës dhe Fushë-Arrësit ishte një shqetësim tjetër i ngritur në këtë panel nga gratë pjesëmarrëse.



Drejtoresha e Shëndetit Publik të rrethit, Sajmira Laci, e ftuar në këtë panel diskutimi, tha se përfshirja e paktë e grave pukjane në vendimmarrje nuk është për faj të tyre. Gratë pukjane kanë aftësitë intelektuale dhe arsimin e nevojshëm për të qenë pjesë e vendimmarrjes, por nuk lejohen nga burrat dhe klanet që krijohen si nga partitë politike dhe shoqëria në përgjithësi. Si anëtare e këshillit bashkiak të Bashkisë Pukë - tha ajo - do të kërkoj që buxheti i vitit 2016 të diskutohet edhe me grupet e interesit të grave para se ai të miratohet nga ky këshill.

Për zgjidhjen e të gjitha këtyre problemeve dhe të tjera që shqetësojnë gratë në rrethin e Pukës, u propozua që të ngrihen këshillat konsultative të grave pranë bashkive Pukë e Fushë-Arrës, sipas përvojës së këshillit konsultativ të grave në ish komunën Gjegjan në vitin 2014. U propozua që ngritja e këtyre këshillave konsultative të grave me qëllim avokati e lobing të mbështetet nga AP, duke u planifikuar në kalendarin e aktiviteteve të saj për vitin 2016. ●



Maqedonia

– e përshtatshme për dhinë saane

Shkraun: dipl. agr. Jelica Beshliq

Dhia saane e ka prejardhjen nga Zvicra, nga rajoni i Luginës Saa-ne. Është marrë me selektim të planifikuar për prodhim të qumështit. Sot ekzistojnë grupe të shumta lokale nga kjo dhi, kurse më të njohurat janë ato zvicerane, gjermane dhe franceze. Duke i vështruar të gjitha karakteristikat e jashtme dhe prodhuese, kjo racë dhie është model ideal i racave të dhive qumështdhënëse me produktivitet të lartë. Ajo e mban rekordin botëror për prodhim të qumështit të dhitë, që është 3028 litra për 305 ditë laktacion.

Karakteristikat e jashtme dhe trupore:

Dhia saane është me ngjyrë të bardhë ndonjëherë me ngjyrë qumështi, me njolla gri ose të zeza te hunda dhe rreth syve. Ajo ka një ndërtim trupor të madh, me kocka të forta dhe me temperament të qetë. Pësia mesatare e dhive është rreth 68 kg, kurse cjeptë peshojnë rreth 90 kg. Gjatësia e trupit është rreth 80 cm tek dhitë dhe 95 cm tek cjeptë. Lartësia pa kokë tek dhitë është 74 cm, kurse cjeptë 85 cm. Ajo më shpesh është shutë, me qime të shkurtër dhe me lëkurë të butë dhe elastike, kurse te cjeptë është më e rrudhur dhe



më e ashpër. Edhe cjeptë edhe dhitë kanë mjekër, veshët i kanë të ngritur drejt, hundën të drejtë dhe jo shumë të thellë. Linja e kurrizit është e gjatë dhe e rrafshët, këmbët janë të fuqishme dhe paralele gjatë ecjes. Dhia saane karakterizohet nga një gjoks i zhvilluar mirë me formë të rrumbullakët, me thitha të përshtatshme për mjelje me makineri.

Karakteristika prodhues:

Dhia saane në kushte të mira strehimi dhe ushqimi, gjatë një laktacioni prodhon deri në njëzet herë më tepër qumësht sesa masa e vet trupore. Ajo është raca që jep më tepër qumësht në botë. Është shumë e përshtatshme për mbajtje në kushte intensive dhe kështu jep rezultate të larta prodhuese. Në laktacion prej 280 ditësh jep 800 litra qumësht, kurse disa dhi japin edhe mbi 2000 litra qumësht. Pjellshmëria është mjaft e lartë, 180%-200%. Këto dhi lindin më shpesh binjakë, por jo rralë edhe trinjakë. Kecat janë me peshë prej 3,5 kg kecat femra dhe 4 kg kecat meshkuj. Kecat e shëndetshëm dhe vitalë kanë rritje ditore prej 200 gramë deri në 2-3 muaj.

Rritja:

Në hapësirat ballkanike kjo dhi mbahet për prodhim të qumështit, por ka rëndësi shumë më të madhe sepse përdoret për rafinim të dhisë vendase ballkanike. Dhia saane është e përshtatshme të mbahet në stalla. Nuk duron rajone të larta dhe të thata dhe nuk konsumon kullotë të varfër. Por, edhe përveç faktit se duhet t'u jepet ushqim në stalla ekonomiksht është e dobishme të rritet për këto arsye:

- prodhim të lartë qumështi gjatë rritjes intensive,
- e përshtatshme për mjelje me makineri,
- për njësi qumështi të prodhuar harxhon 20% më pak ushqim sesa lopët,
- qumështi dhe djathi i dhisë janë më të shtrenjtë se të lopës,
- qumështi i dhisë është më i shëndetshëm, me yndyrë më të ulët dhe tretet më lehtë. ●

Analiza e zinxhirit të vlerës së djathit të dhisë në Rrethin e Pukës

Sipas hulumtimeve në Rrethin e Pukës, ai është fushë me potencial të madh në raport të prodhimit të djathit të dhisë. Djathi i dhisë së Rrethit të Pukës po bëhet atraksion turistik

Shkraun: Dr. Vitor Malutaj

Blegtoria në përgjithësi dhe blegtoria e imët përbëjnë një sektor me rëndësi jetike, i cili siguron për banorët e Pukës të ardhura të konsiderueshme. Rreth 52% e të ardhurave të familjeve pukjane sigurohen nga bujqësia, ku blegtoria zë 57 % të totalit të të ardhurave nga bujqësia. Pothuajse çdo familje në zonën rurale mban nga një lopë dhe disa krerë bagëti të imta. Si duket, vetëm shpërndarja e burimeve kullosore ka bërë që lopa të mbahet afër shtëpisë dhe delja apo dhia në kullotën e largët.

Aktualisht sektori i të imtave duhej të punësonte me kohë të plotë mbi 1500 vetë (100 krerë të imta punësojnë mbi 2 veta), por për shkak të numrit të vogël të të imtave për familje dhe mungesës së kooperimit midis fermerëve vetëm rreth 200 persona mund të konsiderohen të punësuar me kohë të plotë, pasi kanë tufa me mbi 50 krerë bagëti të imta.

I gjithë produkti i zinxhirit në zonën e Pukës është orientuar për vetëkonsum. Rajoni i Pukës prodhon 67.600 kv qumësht në vit, nga të cilat



atij i duhen për nevoja të konsumit jo më shumë se 50.000 kv në vit. Pjesa tjetër prej 17.600 kv përpunohet nëpër shtëpia për të prodhuar djathin, por përgjithësisht shpërdorohet.

Aktualisht Puka ka vetëm dy njësi të përpunimit të qumështit në bazë familje dhe asnjë njësi e cila të destinohet për grumbullimin e qumështit të prodhuesve të tjerë të tij.





Nga bisedat me specialistë e blegtores të Pukës kupton se interesi i tyre për përpunimin është i madh, se kanë arritur të kuptojnë se tregu i djathit të dhisë është i mundur, duke përfshirë qytetet e Pukës dhe Fushë-Arrësit, të cilët po të kthehen në rajone turistike do të rrisin kërkesën për djathin e dhisë.

Studimi i paraqitur është fokusuar vetëm në zonën e Pukës, e cila ka disa karakteristika kryesore daluese që e profilizojnë si një zonë me potenciale të larta në sektorin prodhimor të djathit të dhisë.

Pozita e favorshme gjeografike, pasi Puka ka një shtrirje në sipërfaqe të madhe rreth 1033,69 km², dhe ku sipërfaqja pyjore zë më shumë se 80% të saj, dhe ku diversiteti i florës është shumë i madh duke nisur nga zona e shkurreve mesdhetare, e duke vazhduar me zonën e dushqeve, zonën e pishave dhe ahut, dhe zonën e kullotave malore.

Numri i lartë i familjeve që merren me mbarështimin e dhisë.

Përqindja e konsiderueshme e të ardhurave nga ky sektor në struk-

turën e totalit të të ardhurave që vijnë për familjet pukjane.

Megjithatë rëndësi, blegtoria përballat me një sërë sfidash:

Mungesa e qendrave të përpunimit të qumështit, ku Puka përbën shembull tipik në Shqipëri, pothuajse pa asnjë qendër të përpunimit të qumështit.

Mungesa e një mbështetje të veçantë për sektorin e përpunimit i fokusuar në qendrat e përpunimit model, duke testuar si efektivitetin e prodhimit të djathit të dhisë nga biznesi ashtu dhe nga vetë ferma.

Mungesa e një mbështetje në ngritjen e kapaciteteve të munguara/cunguara të mbështetjes teknike dhe këshilluese, veçanërisht të lidhura me standardet e prodhimit të qumështit dhe përpunimit. Jo pa rëndësi për rrethin e Pukës është bashkëpunimi me qeverisjen vendore, për të marrë përsipër zgjidhjen e çështjes së tregjeve të prodhimeve bujqësore. Pas gjithë procesit të plotë të analizës së zinxhirit të vlerës, me mbledhje të dhënash, me intervista me aktorë të ndryshëm si fermerë,

përpunues, shitës shumice, përfaqësues të pushtetit lokal, donatorë të ndryshëm dhe pas diskutimeve me grupet e fokusit, u rekomandua që:

të punohet për ngritjen e kapaciteteve të familjeve në përpunimin e ruajtjen e djathit për shitje për të afërmit.

Të punohet në ngritjen e dy modeleve të plota të përpunimit të qumështit, njëri në ferme dhe tjetri në biznes.

Të punohet në drejtimin e njohjes së standardeve të prodhimit e përpunimit të qumështit.

Të punohet për krijimin e lidhjeve me tregjet në Shkodër, Lezhë, Tiranë, Durrës dhe tregje të tjera të mëdha, si mundësi shumë e mirë për zgjerimin e prodhimit brenda një kohe shumë të shkurtër.

Krijimi i markës lokale "Djathi i dhisë Puka".

**Përgatiti për botim
dr.Vitor Malutaj**

Ambasadori i Australisë u takua me gratë bletërritëse në Zall Bastar

‘Gruaja, bleta dhe biodiversiteti’, është tema kryesore e një prej projekteve të Shoqatës “Integrimi Gjnor” që ka organizuar trajnime për bletari për një grup prej 30 grash të cilat duan të mbarështojnë bletë.



Shkraun: Dr. Vitor Malutaj

Gruaja, bleta dhe biodiversiteti’, kjo është tema kryesore e projektit që Shoqata “Integrimi Gjnor” ka ndërmarrë me një grup të përkushtuar prej 30 grash që dëshirojnë të mbarështojnë bletë, në njësinë administrative Zall Bastar të Bashkisë së Tiranës. Ky projekt mbështetet nga Qeveria e Australisë dhe inkurajon integrimin e grave në shoqëri, duke synuar vetëpunësimin e tyre, përmirësimin e të ushqyerit të familjeve të zonës ku jetojnë, si dhe rritjen e të ardhurave dhe mirëqenies së tyre personale dhe familjare.

Në ceremoninë e hapjes së këtij projekti modest mori pjesë edhe ambasadori i Australisë në Romë, zoti Mike Rann, i shoqëruar nga bashkëshortja dhe asistentja e tij. Në fjalën përshëndetëse zoti Rann tha se vjen për herë të dytë në këtë njësi administrative, pasi në vitin 2014 gjithashtu ka mbështetur një tjetër projekt, për mbarështimin e dhive. “Rezultatet pozitive që patëm me atë projekt, interesimi i madh dhe korrektësia e fermerëve në zbatimin e

tij na shtynë të iniciojmë edhe këtë vit një projekt tjetër, por tashmë në fushën e bletarisë”, shprehet zoti Rann. Ai theksoi ekzistencën e një lidhje të fortë miqësie dhe bashkëpunimi midis dy vendeve tona, pavarësisht largësisë së madhe gjeografike. Me entuziazëm, shtoi: “Shqiptari i parë ka ardhur në Australi në vitin 1885, por sot komuniteti shqiptar në Australi, i zgjeruar në numër, është shumë i fuqishëm dhe luan një rol pozitiv në jetën dhe zhvillimin e vendit”.

Kryetarja e shoqatës “Integrimi Gjnor”, zonja Lindita Çeçja i shprehu mirënjohjen e saj Ambasadorit për inkurajimin madh, si dhe për mbështetjen financiare të këtij projekti, sado modest që është. Ajo shpjegoi se ky projekt synon të trajnojë 30 gra të kësaj njësie administrative për mbarështimin e bletëve dhe se në fund të këtij trajnimi, grave që kanë fituar njohuritë e mjaftueshme për t’i vënë në praktike, do t’u jepen nga 2 zgjoje me blete për të filluar aktivitetin e tyre të bletërritjes.



Kryetari i Njesisë Administrative, zoti Genci Sita falënderoi Ambasadorin e Australisë dhe shoqatën “Për Integrim Gjnor” për mundësimin e këtij projekti, dhe u shpreh se pushteti vendor është gjithmonë i gatshëm për të bashkëpunuar me çdo donator që mbështet zhvillimin e kësaj zone. Me pas u vazhdua me trajnimin e grave për mbarështimin e bletëve sipas programit, i cili parashikon 8 seanca teorike me 16 orë dhe 8 ditë praktike në Parkun e Bletëve me 64 orë. ●

Rrethi i të mësuarit: Metodë e re për zgjidhjen e problemeve nga AgriNet në Shqipëri



Të gjitha grupet qëllimore në rajonet rurale në Shqipëri e përshëndetën këtë metodë si mjet për të mësuar nga njëri-tjetri dhe mënyrë që të takohen me njëri-tjetrin, edhe pse kjo ishte hera e parë për ta të dëgjojnë për këtë metodë dhe të fillojnë me rrethin e të mësuarit.

Shkruan: Tomi Pikuli, Drejtori
ekzekutiv i Fondacionit Shqiptar

Çfarë është një rreth studimi?

Një rreth studimi është një grup i vogël njerëzish të cilët mbledhen ose takohen disa herë për të diskutuar një çështje. Rrethet e studimit mund të formohen për të diskutuar çdo gjë që nga politika deri tek hobi. Rrethet e studimit krijohen nga persona të cilët kanë zbuluar një interes të përbashkët, rrethe të tjera studimi mund të krijohen për të gjetur ose zgjidhur një çështje sociale, politike ose probleme të zakonshme. Shpesh nuk ka mësues ose drejtues por shpesh një anëtar vepron si lehtësues ose lider për të vazhduar diskutimi. Ky koncept u zhvillua në fillim të shekullit të 20-të në Suedi si pjesë e aktiviteteve në lëvizjet popullore, si pjesë e përmbytjes së lëvizjeve të punëtorëve.

Njohuri dhe puna paraprake për ngritjen e rretheve të studimit

Puna për të promovuar metodën e rretheve të studimit në komunitetin rural në Shqipëri ishte një proces që nisi në fillim të muajit tetor 2013 me takimin në Ferizaj, Kosovë të udhëhequr nga dy konsulentet Suedeze Moa dhe Melina dhe vazhdoi me takime të tjera në terren me gupet e punës. Gjatë kësaj periudhe u bënë një sërë takimesh në terren me anëtarët dhe liderët e rretheve të studimit me mbështetjen e rëndësishme të konsulentëve Suedeze të We Effect. Gjatë një faze tjetër u mbajt një takim me të gjithë grupet e punës e cila iu referua pikave të mëposhtme:

- njohja me njëri-tjetrin e anëtarëve të rretheve të studimit;

- të kuptohej se cilët ishin grupet më të motivuar për të krijuar një rreth studimi;
- të njiheshin nevojat e tyre për të filluar një rreth studimi normalisht.

Nga vëzhgimet e bëra gjatë një periudhe të shkurtër u pa që kishte një interes për ngritjen e këtyre rretheve të studimit në të gjitha grupet e punës. Ata e mirëpritën këtë metodë si një mjet për të mësuar nga njëri-tjetri dhe për t'u takuar me njëri-tjetrin edhe pse ishte hera e parë për ta që dëgjonin rreth kësaj metode. Megjithatë, ne punuam për të ndryshuar këtë mentalitet dhe t'i bindnim ata që rrethet e studimit janë informal, të lira dhe ata vetë duhet të marrin përgjegjësi për të arritur qëllimin.



Organizimi dhe funksionimi i rretheve të studimit

Në fillim numri i rretheve të studimit ishte vetëm 6, në 6 fshatra të ndryshëm në të tri rajonet ku shtrihet projekti. Numri i pjesëmarrësve në këto rrethe studimi në fillim ishte në total 64, përfshi 37 femra dhe 27 meshkuj. Në fazën e dytë numri i rretheve të studimit u rrit në 9, si dhe numri i pjesëmarrësve u rrit në 71, ku 44 femra dhe 27 meshkuj. Vetë anëtarët e RS-së vendosën të takoheshin me njëri-tjetrin 2 ose 3 ose 4 herë në muaj dhe gjithashtu për të pasur një organizim dhe funksionim të mirë të rretheve të studimit u mundësua krijimi i disa materialeve të shkruara. Për RS ku nevojitej opinion më i kualifikuar u bë e mundur pjesëmarrja e specialistëve të fushës për temat e çdo rrethi studimi. Për shtimin e kontakteve dhe rritjen e njohurive u mundësua organizimi i disa vizitave për shkëmbim eksperiencë midis RS-së me të njëjtën temë, por në rajone të ndryshme. Në vazh-

dim tregohen të 9-të rrethet e studimit, vendi, tema, numri i anëtarëve dhe një koment i shkurtër.

Rrethi i parë i studimit u krijua në fshatin Shirgjan në rajonin e Elbasanit me temë "Gatimet tradicionale të Elbasanit dhe rajoneve të tjera", pas vitit të parë ky RS futi dhe receta gatimi nga zona e Korçës dhe Dibrës, kishte 12 anëtarë.

Rrethi i studimit i krijuar në fshatin Vithkuq të rajonit të Korçës ishte i dyti, me temë "Punimet e dorës dhe gatimet tradicionale të zonës së Vithkuqit", pas vitit të parë ky RS e zgjeroi temën e tij duke përfshirë dhe gatimet e kësaj zone, u përfshinë 10 anëtarë.

I treti ishte rrethi i studimit në fshatin Pajovë të rajonit të Elbasanit me temë "Mbarështimi dhe higjiena e gjelit të detit", ishte e arsyeshme që ky RS të vazhdonte të njëjtën temë ku përfshiheshin 11 anëtarë me 5 femra dhe 6 meshkuj.

Rrethi tjetër i studimit shtrihej në fshatin Maqellarë të rajonit të Dibrës me temë "Kultivimi dhe mbledhja e bimëve mjekësore", një rreth ku diskutoheshin eksperiencat e kultivimit të bimëve mjekësore, përbëhej prej 10 anëtarësh të gjithë meshkuj. Duke punuar në të njëjtin drejtim, por me temë të ndryshme "Mbledhja dhe manipulimi i bimëve mjekësore", ky RS ndodhej në fshatin Stëblevë të rajonit të Elbasanit përfshinte 10 anëtarë ku 4 ishin femra dhe 6 meshkuj.

Rrethi i gjashtë i studimit u krijua në fshatin Klos të rajonit të Elbasanit me temë "Blegtoria dhe higjiena e qumështit", ky RS pati si qëllim përmirësimin e kushteve të jetesës së bagëtive dhe higjienës së qumështit, me 8 anëtarë prej ku 3 femra dhe 5 meshkuj.

Një tjetër rreth grash për gatimet tradicionale u krijua në fshatin Maqellarë me temë "Gatimet tradicionale të rajonit të Dibrës", me pjesëmarrjen e 10 anëtarëve.

Rrethi i tetë i studimit u krijua në fshatin Stopckë & Beragozhd të rajonit të Korçës me temë "Teknologjia e prodhimit të dardhave dhe përpunimi i tyre", i përbërë prej 11 anëtarësh, ku 4 ishin femra dhe 7 meshkuj, ky RS u krijua sepse Beragozhdi ishte një fshat i njohur dhe me traditë në Shqipëri për kultivimin e dardhës dhe kjo traditë të mbahej gjallë.

Rrethi i fundit i studimit ishte një grup shumë aktiv prej 10 të rinjsh të cilët dëshironin të ruanin traditën e valleve të zonës, tema e RS ishte "Vallet tradicionale të zonës së Devollit". ●

Përgatitur nga Nikolin KARAPANCI, Asistent Projekti i Fondacionit AgriNet Albania



Megi është projekt bujqësor i IKC-së për ndihmë të grave fermere



Shkruan: Doruntina Kurteshi

Falë IKC-së fermerët e kooperativës “Megi” dinë të ballafaqohen si duhet me sëmundjet dhe problemet e tjera.

Sektori i qumështit është një nga sektorët më të rëndësishëm në Kosovë, i cili ka potencial të lartë të qëndrueshmërisë në prodhim dhe përfitime. Në ndjekje të këtij potenciali, kooperativa “Megi” ka shtuar numrin e anëtareve deri në 40 gra, në mesin e tyre 20 aktive me mesatare të lopëve 5 për anëtare. Me prodhimtarinë e qumështit qëllimi kryesor i kësaj kooperative është gjenerimi i të ardhurave dhe pavarësimi financiar i grave. Pavarësisht izolimit ndëretnik të shqiptarëve dhe serbëve, “Megi” i ka thyer të gjitha barrierat, me përfshirjen e grave nga të dyja etnitë. Përveç të qenit një aktivitet premtues biznesor, ai ka sjellë me vete edhe probleme si numri i madh i baktereve, përhapja e sëmundjes së mastitit dhe higjiena e stallës. Anëtarët e kësaj kooperative kanë pasur mungesë të njohurive se si duhen trajtuar këto sëmundje dhe ku t’i adresonin problemet e tyre.

BASHKËPUNIMI ME IKC-NË

Bashkëpunimi i IKC-së me kooperativën “Megi” është realizuar në forma të ndryshme si në ngritje të aftësive, në shkëmbim të njohurive me grupe të tjera, promovim të produktit si dhe përkrahje me mjete të punës. Pasi hasëm në shumë probleme në kooperativë rreth menaxhimit të fermës, IKC-ja ka angazhuar ekspertë nga fushat përkatëse për organizimin e trajnimeve për luftimin e baktereve, mastitit,

rritjen e higjienës dhe rritjen e cilësisë dhe sasisë së qumështit. Mesatarja e fermës prej 5 lopë për çdo anëtare, konsiderohet se është e vështirë të menaxhohet nga një grua fermere. Në mënyrë që të ruhet sasia dhe cilësia e qumështit kërkohet një interval i qëndrueshëm i mjeljes, zakonisht dy herë në ditë dhe me kohë maksimale ndërmjet mjeljeve. Në mungesë të mekanizmit fermeret kanë humbur në cilësi dhe sasi të qumështit, arsye e cila e ka shtyer IKC-në ta lehtësojë punën e këtyre grave dhe zvogëlojë kohën e panevojshme të humbur duke kontribuar me 15 makina mjelëse për anëtarët e kooperativës.

Fahrije Reçica është themeluese dhe njëkohësisht kryetare e kooperativës “Megi”. Të qenurit kryefamiljare ishte një nga sfidat më të vështira me të cilën znj. Fahrije duhej të ballafaqohej tash e sa vite. Prodhimtaria e qumështit doli të jetë mundësia më e mirë për ta luftuar këtë sfidë, duke rritur numrin e lopëve të poseduara

nga 10 deri në 20 krerë lopë. Nëpërmjet trajnimeve, përkrahjes dhe konsulencës së vazhdueshme të IKC-s kooperative “Megi”, veçanërisht znj. Fahrije arriti të krijojë një qëndrueshmëri financiare për familjen dhe shkollimin e fëmijëve të saj. Meqenëse ruajtja dhe shitja e qumështit janë problem në vete, ajo ka bërë përpjekje për përfitimin e një donacion për themelimin e pikës grumbulluese të qumështit. Përpjekjet e saj kanë dhënë rezultate pozitive, ku tanimë të gjitha anëtarët e kooperativës bëjnë grumbullimin e qumështit në këtë pikë dhe mundësohet shitja e qumështit të freskët.

Padyshim që përfitimet janë të shumëta, mirëpo edhe përgjegjësitë shtesë janë pjesë të pandashme. Si kryetare dhe menaxhuese e pikës grumbulluese ajo negocion çmimin e qumështit me blerësit, siguron inpute bujqësore me cilësi më të mirë dhe çmim më të ulët, dhe çdo aktivitet tjetër që ka të bëjë me menaxhimin e kooperativës.●

Ndikimi i projektit

Ndikimi i projektit në performancën e kooperativës “Megi” reflekton në rritje të cilësisë dhe shitjen e siguruar në kompaninë përpunuese të qumështit Magic Ice. Largimi i baktereve dhe sëmundjeve, rritja e higjienës në stalla ka ndikuar pozitivisht në menaxhim të duhur të fermës. Gjatë trajnimeve teknike dhe përdorimin e mekanizmit mjelës disa nga fermeret përfituese kanë arritur cilësinë e qumështit në ekstra klasë. Me këtë arritje, Ministria e Bujqësisë i subvencionon këta fermerë me 0.06 cent për litër.



MASA AGROEKONOMIKE të domosdoshme për aplikim për subvencione

Masat agroekologjike janë të domosdoshme dhe zbatimi i tyre është i domosdoshëm si masë për aplikim për subvencione në bujqësi në Republikën e Maqedonisë. Për informim më të madh të bujqve Federata e Fermerëve në RM së bashku me Agjencinë për Nxitje dhe Zhvillim organizon sesione informative nëpër shtet që u dedikohen bujqve. Punëtoritë janë mbajtur në Manastir, Shtip, fshatin nga Strumica "Shutka" dhe në fshatin e Tetovës "Kamenjanë". Në këto punëtori kanë marrë pjesë rreth 100 fermerë të cilëve u shpjegua rëndësia mbi masat ekologjike dhe zbatimi i tyre. Aktivitetet janë pjesë e projektit "Mbështetje institucionale e FFRM-së" e cila zbatohet nga Federata në bashkëpunim me WE Effect.

TRAJNIME PËR GRATË FERMERE

Zbatimi i trajnimeve për gratë fermere, si dhe organizimi i evenimenteve. Këto aktivitete Rrjeti i Grave Fermere do t'i implementojë në vitin 2016. Në mbledhjen nacionale të koordinatorëve lokale të Rrjetit të Grave Fermere është theksuar se duhet të punohet mbi rrjetësimin rajonal dhe bashkëpunimin me organizatat e tjera joqeveritare të cilat i mbështesin gratë rurale.



ZHVILLIM I DOMOSDOSHËM I KOOPERATIVAVE

Rreth 40 pjesëmarrës morën pjesë në punëtorinë nacionale për kooperativa të cilën Federata e Fermerëve e ka organizuar në suazat e projektit "Mbështetje institucionale e FFRM-së". Në këtë punëtori janë shqyrtuar aktet ligjore të cilat i përfshijnë kooperativat dhe janë dhënë propozime të cilat do të dorëzohen te Ministria e Bujqësisë. Nga pjesëmarrësit është treguar se ka një trend pozitiv të zmadhimit të numrit të kooperativave dhe formimin e kooperativave të reja, por është e nevojshme të krijohen kushte për themelimin e koopera-

tivave dhe nevojitet edukim dhe informim i cili do të mundësojë zhvillim më të madh të kooperativave.

"Përveç shoqërimit joprofitabil siç janë shoqatat, si një nevojë shumë e madhe shfaqet edhe shoqërimi ekonomik i ekonomive bujqësore që mundëson përmirësim të pozitës së tregut të prodhuesve bujqësorë, si instrumenti më i fuqishëm për vendosjen e aktiviteteve të përbashkëta për magazinim dhe marketing, finalizim dhe shpërndarje, vendosje të standardeve", tha Nikolla Stamenov, presidenti i FFRM-së.





FFRM



FFRM-ja i organizon dhe bashkon fermerët në nivel nacional, me qëllim të përbashkët që të zgjidhen problemet dhe të përmirësohet prodhimtaria në bujqësi dhe zhvillimi rural në Republikën e Maqedonisë. Qëllimi kryesor është të jetë organizatë moderne, transparente dhe demokratike e fermerëve e cila është e njohur në nivel nacional dhe i njeh dhe bashkon pjesën më të madhe të bujqve, i përfaqëson dhe i mbron interesat e tyre dhe vepron në drejtim të përmirësimit dhe zhvillimit të prodhimit bujqësor dhe rajonet rurale në përputhje me nevojat reale të bujqve në Republikën e Maqedonisë. FFRM-ja vepron në nivel nacional, në përputhje me nevojat dhe nevojat e anëtarëve të vetë. Si model i strukturuar hapëron sipas gjurmëve të bujqve suedezë me nënshkrim të marrëveshjes për bashkëpunim me Federatën Suedeze të Fermerëve. Mbi 10.000 njerëz janë përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose indirekte të përfshira në organizatë, domethënë: si anëtarë të organeve të menaxhimit, të punësuarit, vullnetarët, pjesëmarrësit në trajnime për punëtori edukuese, pjesëmarrësit në udhëtimet studimore jashtë shtetit,

në organizimin e panairëve dhe shumë formave të tjera. Përveç kësaj, realizohet bashkëpunim intensiv me organizata nga rajoni, siç janë Shqipëria, Bullgaria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Mali i Zi, Serbia, Rumania, Sllovenia si dhe me organizata nga shtetet evropiane siç janë Suedia, Franca dhe Holanda. Një prej mjeteve më efikase të FFRM-së për informim dhe edukim është revista e saj mujore "Toka ime" e cila është e vetmja revistë mujore në Republikën e Maqedonisë e cila jep komentet dhe mendimet e bujqve, ekspertëve dhe institucioneve relevante, raporte, këshilla edukuese dhe analiza. Në drejtim të zhvillimit të fermerëve të vegjël, bashkëpunimit rajonal dhe kooperativave, FFRM-ja filloi me realizimin e projektit "Zhvillimi institucional i FFRM-së" i cili realizohet në bashkëpunim me organizatën suedeze We Effect.

AGROPUKA



AGROPUKA është një shoqatë e prodhuesve bujqësorë dhe blegtoralë të rrethit të Pukës (Shqipëria e Veriut). Ajo është krijuar në 2001 me mbështetjen e Bashkëpunimit për Zhvillim të Zvicrës (SDC). Që nga ajo kohë, shoqata ka rritur anëtarësinë e saj dhe ka zgjeruar aktivitetin dhe shërbimet, për të plotësuar nevojat e anëtarëve dhe komunitetit në përgjithësi.

Shoqata kontribuon në zhvillimin e integruar rural nëpërmjet inkurajimit dhe promovimit të zhvillimit ekonomik si dhe të iniciativave dhe veprimtarive për të përmirësuar jetesën e anëtarëve të AP dhe komuniteteve që jetojnë në zonat rurale. Në këtë mënyrë AP ndikon në reduktimin e varfërisë dhe padrejtësive sociale në zonat rurale.

Nga viti 2011, Agropuka po zbaton projektin "Të kontribuojmë në përmirësimin e qëndrueshëm të jetës së banorëve të zonave rurale të Pukës" që financohet nga We Effect (Suedi).

Projekti është në fazën e dytë të tij (2014-2016; faza e parë u zbatua gjatë 2011-2013) dhe

synon përmirësimin e qëndrueshëm të jetesës në zonat rurale nëpërmjet rritjes së të ardhurave të fermerëve të vegjël dhe promovimit të demokracisë dhe pjesëmarrjes lokale.

Në tre vitet e ardhshme shoqata do të përqendrohet në tre fusha: (1) Përmirësimin e kushteve të jetesës së anëtarëve të AP dhe të komuniteteve në zonat ku punon AP nëpërmjet promovimit dhe zhvillimit të mëtejshëm të prodhimit, marketingut, dhe modeleve të kooperimit; (2) Promovimin e mbrojtjes dhe zhvillimit të mjedisit; dhe (3) Promovimin e demokracisë lokale dhe përfshirjes sociale të komuniteteve rurale në vendim-marrjen lokale. Për këtë Agropuka do të rrisë qëndrueshmërinë, përgjegjësinë dhe kapacitetin organizativ të saj.



INITIATIVE FOR KOSOVA COMMUNITY-IKC



IKC, Initiative for Kosovo Community është themeluar në vitin 2005 si një prej organizatave lokale joqeveritare në Kosovë. Ajo është formuar si spin-off organizatë e organizatës joqeveritare belgjiane Balkanactie vzw. Ajo është themeluar nga personeli lokal i Balkanctie vzw. Duke ditur se Kosova vuan nga shkalla e lartë e varfërisë dhe papunësisë, përjashtim të grave nga aktivitetet socioekonomike, ne i drejtuam resurset tona kah zhvillimit socioekonomik të Kosovës. Momentalisht IKC-ja po zbaton dy projekte, një të financuar nga Kooperativa Suedeze We EFFECT, kurse tjetri i financuar nga Ambasada Britanike. Të dy projektet kanë për qëllim zhvillimin e shoqërisë rurale të Kosovës nëpër-

mjet organizimit dhe zhvillimit të biznesit. Për faktin se IKC-ja i përfshin të gjitha grupet etnike, gjinitë dhe sidomos bashkësitë e marginalizuara, IKC-ja punon në 10 komuna ku për nevojat për punësim janë më tepër se kryesiale: Ferizaj, Shtime, Lipjan, Viti, Klllokot, Stërpçe, Partesh, Han i Elezit, Kaçanik dhe Gjakova. Deri më tani IKC-ja ka organizuar mbi 700 bujq në organizata të grave (WOS) dhe në organizata bujqësore (FOS). Midis tyre, më tepër se 50% janë WOs, kështu që gratë përforcohen ekonomikisht, politikisht dhe në anën sociale.

FONDACIONI AGRINET ALBANIA



AgriNET është organizatë shqiptare apolitike, joqeveritare dhe jofitimprurëse e regjistruar në shkurt të vitit 2005 me seli në rajonin e Korçës. Tani ajo është rrjetë e 15 organizatave bujqësore nga tre rajone të Shqipërisë. Qëllimi i kësaj organizate është pjesëmarrja aktive dhe e drejtpërdrejtë në proceset sociale, ekonomike dhe ekologjike të zhvillimit të qëndrueshëm të bashkësive të cilat jetojnë në rajone rurale në partneritet me sektorët ruralë të marginalizuar, bashkësitë e tyre dhe palët e ndryshme të prekura. AgriNet e realizon misionin e vet nëpërmjet implementimeve të ndryshme në projektin në fushën e zhvillimit rural financuar nga institucionet vendase dhe ndërkombëtare, si edhe nëpërmjet përfshirjes së drejtpërdrejtë të bashkësive, pushtetit lokal dhe organizatave të tjera joqeveritare në fushën e zhvillimit rural të bashkësisë.

AgriNet siguron shërbime të zgjeruara në pjesën më të madhe të rasteve për grupe formale dhe joformale të prodhuesve bujqësorë.

Lloji kryesor i grupeve bujqësore për shërbime të zgjeruara janë: grupet e prodhuesve të cilët zbatojnë Praktika bujqësore të mira (Good Agricultural Practices - GAP), zbatim i trajnimeve të moderuara nga ekspertë në nivel nacional, organizim i shkëmbimit të përvojave për prodhuesit bujqësorë inovativë, organizim i parcelave demonstruese për testim dhe zbatim të teknologjive inovuese dhe zhvillim të publikimeve të cilat kanë të bëjnë me zbatimin e teknologjive inovuese dhe GAP.